



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 17 TETOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE 17.  
OKTOBRA 2008. GODINE

TETOR –OKTOBAR  
2008

## **Rendi i ditës**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Masat Antidamping,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akreditim,
6. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5,
7. Shqyrtimi dytë i Projektligjit për Noterinë,
8. Miratimi i Rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjdis dhe Planifikim Hapësinor,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa në lidhje me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për shqyrtimin e Raportit të Grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese,
12. Njoftimi i grupve parlamentare të LDK-së dhe të AKR-së për ndërrimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

## **Dnevni red**

1. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o Antidamping merama,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o poljoprivredi i seoskom razvoju,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o akreditaciji,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o podršci malih i srednjih preduzeća br. 02/L-5,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona o beležništvu,
8. Usvajanje Preporuka Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, razvoj sela, životnu sredinu i prostorno planiranje,
9. Razmatranje Preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi predloga Vlade o imenovanju članova Borda Penzijskog Trusta Kosova,
10. Razmatranje Preporuke Komisije za budžet i finansije o razmatranju Izveštaja radne gup za nadzor sprovođenja Zakona br. 02/L-74 o unutrašnjoj reviziji,
11. Razmatranje Preporuke Komisije za budžet i finansije u vezi sa zahtevom Penzijskog Trusta o smanjivanju menadžerske tarife,
12. Informacija parlamentarnih grupa LDK i AKR o zamenjivanju članova skupštinskih komisija.

## **A g e n d a**

1. Approval of the minutes from the previous meeting,
  2. Time for Parliamentary questions,
  3. First reading of the Draft Law on Anti Damping Measures,
  4. First reading of the Draft Law on Agriculture and Rural Development,
  5. Second reading of the Draft Law on Accreditation,
  6. Second reading of the Draft Law on amendment and supplementation of the Law on Supporting Medium and Small Enterprises nr. 02/L-5,
  7. Second reading of the Draft Law on Notary,
  8. Approval of the recommendations of the Committee on Agriculture, Forestry, Rural Development, Environment and Spatial Planning,
  9. Review of the recommendation of the Committee on Budget and Finances regarding the proposal of the Government for nomination of the Kosovo Pension Trust Board,
  10. Review of recommendation of the Committee on Budget and Finances on reviewing the report of the working group on supervising the implementation of the Law no. 02/L-74 for internal audit,
  11. Review of recommendation of the Committee on Budget and Finances regarding the request of the Kosovo Saving Pension Trust for reducing the management fee (tariff),
  12. Notification of the Parliamentary groups of LDK and AKR on replacement of the members in the Parliamentary Committees.
- 

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup Krasniqi**.

**KRYETARI I KUVENDIT:** Të nderuar deputetë,  
I nderuari Kryeministër,  
Zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritarë,

Mirë se keni ardhur në seancën e rregullt plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 82 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

**MYZEJENE SELMANI:** Faleminderit Kryetar!

Njëkohësisht kisha kërkuar prej të nderuarve kolegë deputetë që pika e 5-të e rendit të ditës - Shqyrtimi i Projektligjit për akreditim, për disa shkaqe teknike të hiqet nga rendi i ditës në rast se ka mundësi deri në seancën e ardhshme.

KRYETARI: Të nderuar deputetë, ju e dëgjuat propozimin e kryetares së Komisionit, andaj kërkoj një votim formal.

Shtyhet për seancën e radhës. Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka abstenime. Atëherë pika pestë e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës. Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuari zoti Kryetar,  
I nderuar zoti Kryeministër me Kabinet qeveritarë,  
Të nderuar dhe të respektuar kolegë deputetë,

Para se ta aprovojmë rendin e ditës, unë kam një propozim që ishte edhe propozim i legjislaturës së kaluar, i shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, por unë dua ta ritheksoj tani, ta ripërsërisë, ta ripropozoj, që mbështetur në Rezolutën numër 148/ janar 2006, ose saktësisht të 25 janarit 2006, të Këshillit të Evropës, ku thërret për të dënuar krimet komuniste në ish botën e lindjes, unë propozoj këtu në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së që këtë dënim në formë të një rezolute ta bëjë edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe në këtë mënyrë unë propozoj që ky Kuvend ta autorizojë Komisionin për Legjislacion që ta hartojë rezolutën dhe në një seancë të radhës ta aprovojmë si të tillë, natyrisht, duke e plotësuar si Kuvend i Republikës së Kosovës. Ju e dini mirë se cilat janë krimet që kanë ndodhur në Kosovë dhe unë nuk dua këtu t’ju mbajë leksion, sepse në fakt do t’ju them gjërat që ju i dini, por një gjë dua t’ju theksoj që nga viti ‘41 gjer në ‘58, 62.000 të vrarë janë në Kosovën tonë të vogël. Faleminderit!

KRYETARI: Kemi një mocion nga shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që të ngarkohet Komisioni për hartimin e një rezolute për dënimet e krimeve. A jeni që ta ngarkojmë komisionin përkatës për hartimin e rezolutës?

Ju lutem, atëherë shkojmë në procedurën e votimit. Ju e dëgjuat propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotit Ramë Buja.

Ju lutem, ju e dëgjuat. Urdhëro Ramë, e ke fjalën!

RAMË BUJA: Konsideroj që është e qartë, por megjithatë, meqë ndihet nevoja për ta sqaruar, po e sqaroj.

Është fjala për një rezolutë, ku do të dënohen krimet komuniste të bëra në territorin e Republikës së Kosovës dhe unë nuk dua të sqaroj më shumë. Të gjithë i dimë, mund t’i saktësojmë edhe historikisht dhe mund t’i marrim edhe numerikisht se sa janë këto krime, po krimet komuniste në Kosovë.

KRYETARI: Të përcaktohen vitet, ne e dimë kur është, e kemi 1944/45, deri më 1999. Mendoj që kjo është e përcaktuar. Atëherë, kërkoj prononcimin e shefave të grupeve parlamentare. Kush do ta marrë fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës? Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar i Kuvendit,  
Zotëri Kryeministër, ministra,  
Kolegë të nderuar,

Ne s'kemi veç se ta mbështesim një ide të cilën në formë të idesë elementare artikuloi sot kolegu Ramë Buja, në emër të një partie, të Partisë Demokratike në Kuvendin e Kosovës. Unë mendoj që sot nuk është mirë të bëjmë kurrfarë votimi të veçantë. Si iniciativë ne e përkrahim. Ne mendojmë që kjo është një, ta quajmë ne, kusht i Bashkimit Evropian, i cili ka ndërtuar një rezolutë dhe pak a shumë reflekton ndërtimet e rezolutave të tilla në botën eks- komuniste, kështu që unë mendoj që sot po shpreh mendimin këtu për këtu, ne e përkrahim iniciativën e tillë, po sot s'ka çka të votohet. Përkrahet iniciativa që të ndërtohen, janë mekanizmat tutje të Kuvendit të Kosovës si ndërtohet ajo rezolutë, si përkrahet dhe si votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Shefi i Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli e ka kërkuar fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!  
Zoti Kryeministër,  
Zotëri ministra,  
Të nderuar kolegë,

I bashkëngjitëm iniciativës së shefit të Grupit Parlamentar të PDK-së. Kosova ka me mijëra, me miliona arsye që t'i dënojnë krimet e komunizmit në Kosovë të shkaktuara jo vetëm në periudhën ose prej periudhës '44 – '45 e këndeje, por që nga viti '41 e këndeje, krime të cilat mund të thuhet me vlerësimet më të mëdha se kanë qenë krimet më monstruoze që kanë ndodhur ndaj shqiptarëve në Kosovë. Ne, si grup parlamentar e përkrahim këtë iniciativë.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, shkojmë sipas radhës. Fjalën duhet ta ketë shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!  
Po ashtu, e mbështesim këtë iniciativë, po ashtu besojmë edhe ne sikur përfaqësuesi i Lidhjes Demokratike se ka qenë dashur të na vijë prej komisioneve dhe tek atëherë të diskutojmë dhe të votojmë. Sidoqoftë, edhe një çështje tjetër është këtu, se Rezoluta e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës flet për krimin e regjimeve komuniste në të gjitha vendet postkomuniste dhe ne mendoj se duhet të jemi në vijën e njëjtë, jo ne të kufizohemi vetëm në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Gani Geci e ka kërkuar fjalën.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mua po më vjen keq që Grupi Parlamentar i PDK-së po i lë shokët vetëm, sepse ju e dini çka ka ndodhur para disa ditësh, pikërisht për ditëlindje të diktatorëve dhe të komunizmit. Prandaj, ne dëshirojmë që kur të vijë ajo rezolutë që doni ta aprovoni, të jetë për të gjithë shqiptarët, sepse nuk kemi shqiptarë veç në Kosovë, kemi edhe në Shqipëri dhe kemi pasur vrasje shumë të mëdha, vrasje marramendëse që kanë ndodhur në Shqipëri, andaj komunizmi nuk ka bërë krim vetëm në Kosovë, por komunizmi ka bërë krim edhe në Shqipëri dhe Tito e Enveri kanë qenë shokë deri në vitin 1948. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Urdhëro Ramë, si propozues!

RAMË BUJA: Megjithëse ndjejmë një dëshirë që të dënojmë komunizmin skaj më skaj dynjasë, por nuk kemi mundësi ta bëjmë ne si Republikë e Kosovës, si shtet i vogël që jemi. Ne kemi mundësi, kemi kompetenca, kemi të drejta dhe detyrime ta bëjmë këtë dënim për atë që sa mundemi në Kosovën tonë. Unë jam ithtar i asaj që ta dënojmë në mbarë botën, sepse dihet se çfarë ikone kanë lënë në këtë gjë, por megjithatë nuk mund ta bëjmë këtë. Ne duhet ta bëjmë për atë që kemi obligim dhe detyrë që ta bëjmë dënimin me një rezolutë që nxirret nga Komisioni gjegjësisht dhe pastaj mund ta shtojmë e përplotësojmë dhe ta votojmë një ditë të caktuar. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit shumë!

Sipas radhës, duhet të jetë Grupi Parlamentar “7+”. Nuk doni. Mirë!

Grupi Parlamentar SLS. Nuk ka.

Deputetë, po ju them, nuk keni nevojë tani për debat. Nëse Kuvendi do ta ngarkojë një komision, pastaj bëjmë debat më vonë. Unë kisha kërkuar me një votim formal të ngarkohet komisioni. Kaq kemi sot, për hera të tjera mund të bisedojmë më vonë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

(Reagime, nuk dëgjohet për transkriptim)

Rezoluta i cakton, ne s’po i caktojmë sot.

Ju lutem, ajo përcaktohet në rezolutë. Ngarkohet komisioni, komisioni e bën rezolutën, çdo grup parlamentar ka anëtarë të vetë atje dhe le ta përpunojnë.

Shkojmë në votim formal, kush është “për”? Faleminderit shumë!

Kush është “kundër”? Nuk ka. A ka abstenime? 4 abstenime.

Megjithatë, Kuvendi sot me shumicën absolute të anëtarëve të tij ngarkon Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi për hartimin e rezolutës. Ju faleminderit!

Ne kemi disa që e kanë kërkuar fjalën. Sipas radhës këtu që e kemi, deputetja Gjylnaze Sylja e ka fjalën.

GJYLNAZE SYLA: Për pikën një e kam kërkuar, Kryetar.

KRYETARI: Ende nuk kemi dalë në pikën një.

GJYLNAZE SYLA: Ani, kur të vijë.

KRYETARI: Atëherë, Fatmir Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni lidhur me rendin e ditës që e shtruat sot, të jap një vërejtje timen si deputet. Ndoshta nuk u kuptuam në Grupin Parlamentar, ose po mungon shefi i Grupit Parlamentar, zotëri Lutfiu, prandaj unë do të paraqes këtu para juve, që pika 9 edhe pika 11, që ka të bëjë lidhur me Trustin e Pensioneve, mendoj që nuk është mire të shqyrtohen sot në rend dite pa e pasur edhe një informatë nga ana e Qeverisë, se çka ka ndodhur në institucionin e Kosovës, të kursimeve tona të mbi 400.000 punëtorëve, e tek më vonë t'i shohim këto pika, t'i trajtojmë. Lidhur me Bordin, menaxhimin e asaj paraje publike, vlerën e saj, humbjet që kanë ndodhur dhe privilegjet dhe krejt çka ka pasur një Bord i mëhershëm, menaxhmenti i mëhershëm, në mënyrë që, vërtet, në bazën e kësaj informate të plotë ta njoftojmë opinionin, por edhe të merren rekomandimet dhe masat që duhet t'i vazhdojë tutje Qeveria.

Kujtoj se nuk e ka kryer punën e vet Qeveria, në qoftë se sot i përfundojmë këto dyja, pa këtë pjesën e parë. Prandaj, unë e shoh të rrugës që në mungesë informate, këto dy pika të shtyhen për seancën tjetër dhe të përgatitet një informatë e plotë, e tek atëherë të bëjmë zgjidhje të tjera.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, fjalën duhet ta marrë kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Gani Koci e ka fjalën, sepse Rekomandimet kanë ardhur nga Komisioni.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ne vërtet sot kemi në rend të ditës dy çështje që kanë të bëjnë me Trustin Pensional të Kosovës.

1. Zgjedhjen e anëtarëve të Bordit, dhe
2. Përcaktimin e tarifës menaxhuese, që trusti ka kërkuar një zbritje të kësaj tarife

Dhe, tash, nëse është fjala për përcaktimin ose për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit, duhet të njoftoj Kuvendit këtu, por edhe Qeverinë që procedura për zgjedhjen e Bordit ka nisur qysh në mars të këtij viti dhe Komisioni përzgjedhës, që ka qenë një Komision ex officio, i përbërë, propozimet për anëtarë të Bordit pas marsit ia ka bërë Qeverisë, sipas Rregullores së funksionimit të Trustit dhe detyra ka qenë që me një opinion të Qeverisë të vendosë Përfaqësuesi Special. Kjo nuk ka ndodhur për shkak të lëvizjeve dhe të angazhimeve që i kemi pasur, ju e dini, në fazën e marsit, prillit, majit dhe qershorit. Ndërsa, në qershor kemi miratuar ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut rreth Trustit

Pensional, ku përcakton ndryshe zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të këtij Trusti. Sipas Ligjit mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, Komisioni përzgjedhës që përbëhet nga Guvernatori i Bankës Qendrore dhe zyrtarja ose anëtarja e Bordit të Zyrës të Revizorit Gjeneral, bashkë me sekretarin e përhershëm, si organ përzgjedhës, nga një konkurs publik bëjnë përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit dhe këtë përzgjedhje e dërgojnë në Kuvend, që Kuvendi pastaj të kërkojë një opinion nga Qeveria lidhur me propozimet dhe pastaj me këtë opinion vendos Kuvendi për përzgjedhjen e tyre. Ne e kuptojmë se këto procedura për shkak të asaj që nuk është nënshkruar në kohën kur është dashur të nënshkruhet, kanë kaluar në një rrugë tjetër, në Qeveri dhe ..

**KRYETARI:** Le t'i vazhdohet fjala!

**GANI KOCI:** ...Komisioni në kërkesën e parë të Qeverisë nuk ka vendosur dhe ka kërkuar plotësim, ka kërkuar komplet raportin e Komisionit përzgjedhës dhe ne i kemi edhe referimet e këtij komisioni përzgjedhës, arsyetimet e këtij komisioni, të cilat i kanë edhe deputetët nëpër materialet e tyre dhe konform këtyre shpjegimeve Komisioni ka vendosur që ta fusë këtë pikë në rend të ditës që Kuvendi të votojë lidhur me kandidatët për anëtarë të Bordit të Trustit Pensional. Kjo është për sa i përket përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit. Ndërsa, sa i përket tarifës menaxhuese, në mungesë pikërisht të këtij Bordi, Komisioni nuk ka mund të marrë një raport lidhur me angazhimet dhe veprimtaritë e krejt trustit dhe, sipas ligjit, për çdo vit ka një zbritje të kësaj tarife. Këtë vit, ku jemi, 0.9%, ndërsa kërkesa e tyre është që të zvogëlohet për vitin 2009 në 0.8%, që do të thotë një ndryshim atje që kërkohet sipas ligjit. Ne, si Komision, me shpjegimet e disave, po them, të përgjegjësve të Trustit, jo të Bordit të Trustit, kemi ardhur në përfundim se Kuvendi duhet të miratojë këtë tarifë me arsyetimin që Trusti pas kompletimit të Bordit të Trustit, të kërkohet informacion i plotë lidhur me veprimin dhe angazhimet e Trustit në përgjithësi. Këto janë arsytet, prandaj nuk do të duhej të hiqen nga rendi i ditës këto dy pika. Edhe ashtu ne jemi të vonuar me Bordin e Trustit Pensional të Kosovës.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Atëherë, fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministri, zoti Hajredin Kuçi.

**ZËVENDESKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Deputeti Fatmir Rexhepi e ka ngritur edhe herën e kaluar të njëjtën çështje dhe ne si Qeveri jemi pajtuar tërësisht. Po e theksoj prapë, Trusti Pensional nuk i përgjigjet drejtpërdrejt Qeverisë. Po e theksoj se Kryeministri i ka dërguar një letër Guvernatorit të Bankës duke kërkuar llogari për mjetet e Trustit, për menaxhimin e tjerat, dhe ende nuk kemi marrë përgjigje, por mendoj që Kuvendi duhet ta bëjë punën e vet dhe të kërkojë llogari formale nga ai.

Në anën tjetër, pika e dytë që ishte lidhur me emërimin e anëtarëve, po e them që në këtë procedurë kjo qeveri aktuale nuk ka marrë pjesë, kanë qenë propozime paraprake, kanë qenë propozime që janë miratuar nga qeveria paraprake, nga komisionet paraprake dhe nga zoti Ryker. Ndërsa, ne, nuk kemi dashur ta fitojmë përshtypjen që po e refuzojmë

dikë, i cili ka qenë këshilltar i ish kryeministrit, ka qenë këshilltar i një ish kryeministri tjetër apo diçka tjetër, por dua të them që kjo qeveri nuk insiston në kandidaturat e propozuara, nëse Kuvendi i voton, ne do t'i respektojmë, por jemi gjithsesi që të jepet raport i plotë për Trustin Pensional të Kosovës, për punën, për mjetet dhe gatishmërinë që do ta ketë para Kuvendit.

Për emërimin dhe çështje të tjera le të vendos Kuvendi, ne e respektojmë vendimin. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!  
Fjalën e ka kërkuar Sabri Hamiti

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar, këtu u paraqit një kërkesë e artikuluar nga deputeti Rexhepi, arsyeshëm. Ishte një kërkesë që në të vërtetë ishte sublimim i mbledhjes së Grupit Parlamentar, që e kemi mbajtur sot rreth rendit të ditës. Shefin nuk e paskemi këtu, por kjo nuk do të thotë gjë.

Logjika e analizës tonë thotë, që sot nuk është mirë të votohet për atë bord. Argumentet janë këtu, dikush edhe i përmendi copa - copa, që është një procedurë që ka zgjatur shumë, që është një procedurë që është iniciuar në një gjendje tjetër kushtetuese të Kosovës dhe po votohet në një gjendje krejt tjetër Kushtetuese të Kosovës, është një Bord që ka të bëjë me një Agjenci për të cilën ne kemi vërejtje edhe si Kuvend, por edhe si publik, edhe si interes qytetar e shoqëror, për të cilën nuk i kemi njoftimet elementare çfarë po ndodhë, sidomos pas tronditjeve të financave, e ju e dini që ato pare nuk janë këtu hiq. Është një vërejtje që struktura përfaqësuese ligjore nuk ekziston në emrat e propozuar, e të tjera. Pra, logjika e Grupit tonë Parlamentar ka qenë, që është koha të rianalizohet.

Unë e dëgjova me vëmendje zëvendëskryeministrin dhe ky i paraqet në njëfarë mënyre këto dilema, meqë edhe Qeveria nuk insiston që të jetë kjo sot, Grupi ynë ka menduar se është mirë që Kuvendi të mendojë për të gjitha këto probleme, e mbi të gjitha të ketë një raport detaj për hatër të qytetarëve, të interesit të tyre, por edhe të Kuvendit për këtë trust. Kaq. Ju faleminderit! Kjo është esenca e asaj që e kemi ne.

KRYETARI: Ju faleminderit!  
Në emër të Grupit të AKR-së, kush e kërkon fjalën? Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!  
Meqenëse është bërë praktikë se pozita gjithmonë po e orienton Kuvendin se si të marrë vendime, foli kryetari i Komisionit, vazhdimisht kemi pasur vërejtje, se kur paraqet Komisioni diçka, dihet mirëfilli se këtë Komision e bëjnë tre anëtarë të PDK-së dhe 3 të LDK-së, që janë mazhurancë në Komision dhe sot kanë probleme me grupet e tyre parlamentare.

Ne i kemi dhënë vërejtjet tona në Komision lidhur me kandidatët. Nuk kemi dhënë vërejtje për procedurat edhe për periudhën e kushtetutshmërisë valide në atë periudhë

apo në këtë periudhë, ne nuk kemi zbritur drejt në Kushtetutën e Republikës, i dimë rrethanat qysh kemi vazhduar. Është e domosdoshme që institucionet edhe këto borde të jenë të aprovuara nga Kuvendi, mirëpo po shihet se përkatësia politike edhe ana më e madhe, që mazhuranca e Kuvendit edhe pozita që i drejton pozicionet, po ka dëshirë të luaj sepse iu nevojiten emrat, që njerëzit e vet t'i kenë atje.

Ne edhe ashtu do të votojmë kundër, edhe në qoftë se miratohen propozimet për Bordin e Trustit Pensioknal, mirëpo për rrethanat procedurale ligjshmëria flet, keni edhe ndihmësit e administratën përreth, ta shohim qysh po shkojnë procedurat më tutje. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Jo, jo, ju lutem! Realisht, është propozim. Shefat e grupeve parlamentare ose e mbështesin, ose nuk e mbështesin. Nuk ka nevojë për komente shtesë. Unë jam i obliguar të them diçka, por pasi t'i thonë...

Fjalën e ka Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Prapë se prapë nuk po mundemi pa i bërë disa komente shtesë, se është politikë këtu dhe neve në opozitë po na vjen nganjëherë për dore, kur po ndodhin këso ngjarjesh. Mendoj se një vit pa një muaj rrafsh, pas zgjedhjeve të vitit të kaluar, duke pasur parasysh se çfarë peshe ka Trusti Pensioknal, të vijë dikush dhe të na thotë sot se propozimi është prej ish qeverisë, do të thotë një vit pa një muaj rrafsh, sot jemi më 17 tetor, dhe të përsëritet edhe një herë këtu në Kuvend, për shkak se nuk merren vesh në mes veti dy partitë në pushtet, ne të votojmë ose të mos votojmë për diçka, po ndodhë shumë shpesh. E njëjta gjë vlen edhe për ne, nuk e votojmë as këtë listë që është, as ndonjë listë tjetër, mirëpo mendoj se duhet të thuhet, duhet të precizohet saktë, do ta precizojmë edhe në media se ka kaluar shumë kohë e gjatë, kanë ndodhur shumë... rreth Trustit dhe Qeveria sot vjen me propozim të vitit të kaluar dhe thotë në dashi votoni, në dashi mos e votoni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Naser Rugova e ka fjalën!

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zotëri kryetar!

Të çmuar kolegë deputetë,

Kryeministër me Kabinet qeveritar,

Vërtet në Kosovë është folur shumë për Trustin, për mjetet e Trustit, për investimet e këtyre mjeteve, mosinvestimin e këtyre mjeteve në Kosovë, për zhvillimin ekonomik, për pagat e larta të të punësuarve në këtë Trust, çka është thënë, ... nuk është thënë. Në vazhdimësi, edhe qytetari i Kosovës, edhe kontributdhënësit, po edhe institucionet nuk kanë pasur qasje konkrete dhe nuk ka transparencë në këtë kuptim.

Ne e kemi shqyrtuar si Lidhje Demokratike e Dardanisë me vëmendje edhe Raportin që e ka dhënë Komisioni për Buxhet dhe Financa, i cili thotë se nuk është proceduar konform ligjit. Propozimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës nuk është bërë në bazë të Ligjit nr. 03/1-048 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së UNMIK-ut, 2005/20

dhe në këtë propozim, tani edhe të Komisionit përzgjedhës, një kohë ka qenë drejtori i Autoritetit Qendror Bankar, pastaj është nënshkruar nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe është një konfuzitet i tërë.

Ne i kemi shikuar edhe emrat me vëmendje. Për hir të qytetarëve dhe të opinionit më duhet të cekë se neni 5.4, pika (d), parasheh që njëri prej anëtarëve të propozuar të jetë dijetar i shquar në fushën e shkencave ekonomike ose financiare, që ka bërë hulumtime të gjëra akademike të pranura ndërkombëtarisht dhe që ka punime shkencore lidhur me investimet private pensionale, kurse propozohet për kryesues të këtij Bordi tejet të rëndësishëm, që bëhet fjalë për qindra miliona, e nga një 25 e 30 po hupin me çdo ndryshim në tregjet financiare, propozohet një emër, një djalë i ri 29 vjeçar, që nuk është ekonomist, është shef i resurseve humane...

KRYETARI: Regjia, le t'i vazhdohet koha edhe një minutë!

NASER RUGOVA: ...është shef i resurseve humane në Hekurudhat e Kosovës. Çfarë mesazhi u jepet kontribuuesve të këtij Trusti dhe qytetarëve të Kosovës?

Lidhja Demokratike e Dardanisë kërkon që të vijë një raport detaj nga Trusti, nga Qeveria. Ne nuk do ta votojmë këtë propozim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Gani Koci e ka kërkuar fjalën në emër të Komisionit.

GANI KOCI: Natyrisht, në emër të Komisionit, gjithnjë në emër të Komisionit sot për këtë çështje.

Ne në Komisioni nuk e kemi shtruar çështjen e personaliteteve dhe të njerëzve që kanë konkurruar dhe janë përzgjedhur nga Komisioni përzgjedhës, absolutisht, sepse e kanë pasur komplet dokumentacionin me CV-të e tyre.

Atë që e lexoi zotëria më herët, si vendim i Komisionit, pikërisht nga ajo që nuk është proceduar me vite sipas ligjit, është kërkuar plotësim dhe plotësimi ka ardhur me vonë. Do të duhej të shikoni letrën e 27 marsit, dërguar nga Komisioni përzgjedhës zotit Ryker atëherë, dhe ta shihni letrën e zotëri Ryker që i dërgohet Kryeministrit të Kosovës lidhur me anëtarët përzgjedhës, dhe e shohim vendimin e Qeverisë të Kosovës, që thotë: Qeveria e Kosovës propozon anëtarët e Bordit drejtues të Trustit Pensional të Kosovës në këtë përbërje. Edhe sipas Ligjit të vjetër, Rregullores, edhe sipas ligjit të ri, Qeveria jep vetëm mendimin lidhur me anëtarët e Bordit ose jep opinionin, prandaj kjo ka qenë arsyeja dhe Komisioni që e ka kërkuar që i tërë dokumentacioni të na vijë nga Komisioni përzgjedhës i Trustit Pensional dhe tek pastaj ne të marrim opinionin e Qeverisë.

Opinionin e Qeverisë është ky vendim dhe mbi bazën e kësaj, Komisioni e ka përfunduar punën e vet. Është çështje e Kuvendit a do të përzgjedh ose jo.

U lexua edhe neni 5.5, po të lexohen edhe ndryshimet që janë bërë në nenin 5.5 dhe aty thuhet troç se një ekspert nga fusha e ekonomisë, një përfaqësues, thuhet përfaqësues, por që ka të bëjë me botën e biznesit dhe një tjetër që ka të bëjë me ata, me...

KRYETARI: T'i vazhdohet fjala deputetit!

GANI KOCI:... ne nuk e dimë nga Komisioni sa janë përfillë këto kritere. Ka qenë çështje e tyre, por një dua të them se të gjitha këto komunitete nuk i kanë deleguar njerëzit e vet. Konkursi ka qenë publik dhe kanë konkurruar njerëzit. Mbi bazë të konkurrimit këta janë përzgjedhur. Se a i kanë plotësuar kushtet a jo, është çështje e Komisionit përzgjedhës. Mbi bazën e raportit del se këta i kanë plotësuar kushtet dhe do të duhej të vendosej në Kuvend lidhur me zgjedhjen e tyre.

Asnjë material tjetër shtesë lidhur me këtë çështje, të jeni të bindur, nuk do të keni, sepse nuk ka material shtesë tjetër, këto janë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Shikoni, ne e kemi një propozim nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Kërkesën për ta shtyrë, unë e respektoj, por disa raporte që po lypen, besoni, unë i kam pasur disa komunikime, nuk mund të bëhet pa Bordin dhe faktikisht vonesa në Bord e pengon punën e raporteve, por edhe punën e Trustit në përgjithësi, si administratë.

Megjithatë, unë jam i detyruar ta qes në votim kërkesën e Grupit Parlamentar për ta shtyrë pikën 9 dhe pikën e 11-të. Fatmiri kërkoi shtyrjen e dy pikave. Urdhëro Sabri, edhe një herë!

SABRI HAMITI: Zotëri Kryetar! Ai kërkoi ashtu, por ato nuk janë krejt të lidhura, nëntëshi është e veçantë, njëmbëdhjetëshi e veçantë. Unë mendoj se nuk duhet të votohet një herë për të dyja, por në mënyrë të veçantë. Kaq!

KRYETARI: Atëherë, e keni propozimin vetëm për pikën e nëntë. Po shkojmë në votim formal.

Kush është për propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, ose të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike për tërheqjen nga rendi i ditës të pikës 9 - Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës?

Kush është "për"?

Sekretaria, numëroni saktë votat.

Prezentë janë 83 deputetë. Kanë votuar 53 "për".

Kush është "kundër"? "Kundër" 11. Kush abstemon? 10 abstenojnë. Konstatohet se me 53 vota "për" shtyhet kjo pikë, pika 9 e rendit të ditës për seancën e ardhshme. Ne duhet në seancën e ardhshme të vendosim ose për votim ose jo. Do të thotë, shtyhet për seancën e ardhshme. Ju faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

Unë u lajmërova edhe për pikën e kaluar, por nuk m'u dha rasti, veç desha një korrigjim. Po me vjen keq, ka shumë historian këtu, por komunizëm nuk ka pasur prej '41-shit këtu, komunizmi ka qenë prej '44 deri në '90. Ne nëse duam ndonjë rezolutë për autrocitetet e Serbisë në Kosovë, atëherë data shtyhet në vitin 1878. Këto le të qartësohen për opinion. Në vitet e '90-ta këtu ka pasur racizëm, ka pasur aparteid, nuk ka qenë sistemi monist dmth komunism, sidoqoftë. Për pikën e 9-të, unë nuk di pse po e shtyjme. Ne përsëri do të bisedojmë për tre kandidatët e njëjte te servuar këtu.

Për pikën e 11-të, ju lutem, nëse shtyhet, le të insistohet që të na sjellin shifra, nga se prej 1% në 0.8% neve nuk na tregon kurrjë hiq. 0.8% mund të jetë 10 milionë, flas për këtë tarifën menxhuese, mund të jetë 20 milionë, mund të jetë edhe 10 mijë euro. Ne nuk e dimë 0.8% sa është, le të na sjellin me shifra të cilat të gjithë i kuptojmë, edhe numrin e punëtorëve atje, pastaj ne i llogarisim. Kaq desha të them. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Propozuesi u tërhoq nga pika 11.

E kemi Raportin e komisionit përkatës dhe mendoj që nuk kemi çka shtojmë tjetër.

Fjalën e ka kërkuar, deputetja Gjylnaze Sylja.

Kryetar, unë e kërkoja më herët për atë pikën që u diskutua, por nuk ma dhatë fjalën. Tash po pres për pikën e parë përsëri. Nuk ma dhatë fjalën kur e kërkoja, kur ishte duke u shqyrtuar çështja e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional, atëherë e kërkoja fjalën, por në qoftë se ma jepni fjalën, unë do të flas për këtë.

KRYETARI: Shikoni, unë e kërkoja mendimin e shefave të grupeve. Shefi i Grupit të juaj Parlamentar e dha fjalën dhe unë mendoj që nuk kemi nevojë tjetër. Fjalën e ka kërkuar, deputeti Ramadan Avdiu!

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zotëri Kryetar!

I nderuar zotëri Kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Unë do të flas rreth pikës 11, meqenëse u votua, do të thotë, ndaras vetëm pikën 9, atëherë në rast se do të shtyhet edhe pika 11 e rendit të ditës, do t'u propozoja që Trusti t'i bëjë një propozim Kuvendit, në mënyrë që t'i caktohet një buxhet fiks për arsye se të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë funksionojnë dhe veprojnë mbi bazën e buxhetit, buxhetin e kanë të fiksuar, sepse kjo me përqindje nuk mund të..., ne nuk kemi asnjë informacion, do të thotë. Kjo me përqindje është ulur, ne mund të shkojmë, ndoshta është edhe një grackë këtu nga propozuesi, për arsye se ulet shkalla e ndarjes për nevoja të menaxhmentit të Trustit të Kursimeve, kurse baza e inkasimit është zgjeruar, sepse çdo ditë punësohen punëtorë të ri dhe ka depozitues të ri në Trustin Pensional. Kështu që, unë do të kërkoja që në rast se kjo pikë do të hiqet nga rendi i ditës, atëherë për seancën e radhës ne të kemi një propozim dhe si të gjitha organizatave buxhetore në Kosovë, edhe Trustit të Kursimeve Pensionale t'ia ndajmë buxhetin fiks, e

jo t'ia lëmë në mënyrë..., do të thotë varësisht nga të hyrat edhe ata të realizojnë ndarjen për nevoja të menaxhmentit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Unë kisha dëshiruar që vërtet t'i njohim ligjet e pastaj të kërkojmë. Është mirë që kërkesat kur t'i bëni, t'i mbështetni në ligjet e caktuara dhe nenet e caktuara. Na i kemi rekomandimet e Komisionit përkatës, ku marrin pjesë të gjitha grupet parlamentare. Është në rend dite dhe mbetet në rend dite.

Më duket, Gani, nuk ka nevojë për diskutim, po shkojmë sipas rendit të ditës. Fjalën e ka deputeti Gani Koci, vetëm shkurt!

GANI KOCI: Meqë e the atë çështjen, vërtet propozimet që bëhen, të bazohen në ligj. Merreni Rregulloren 2005/20, e cila përcakton mënyrën e ndarjes së fondit dhe mënyrën e menaxhimit të fondit ose të kësaj tarife, që është një tarifë zbritëse për çdo vit, dhe merrni ndryshimet e kësaj Rregulloreje që janë bërë më 15 qershor, nëni 18, pika 5.17 dhe po t'i kishim lexuar këto, vërtet nuk do të dilnim shumë qesharak këtu me propozime të natyrave që nuk përkojnë me këtë, absolutisht. Kjo mund të jetë diçka, ndoshta ka një logjikë, por jo e mbështetur në ligj.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës. Ju lutem, në Kuvend ka rend dhe fjala kërkohet. Ne e kryem këtë, lexoni ligjet tjera herë dhe e plotësojmë.

### **- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 3 dhe 10 tetor 2008**

Ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 3 dhe 10 tetor 2008, si dhe transkriptet nga këto seanca, u janë shpërndarë deputetëve.

Pyetjes së deputetëve, nëse kanë vërejtje në procesverbale?  
Fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Sylaj!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Në seancën e kaluar unë ia kam bërë një propozim Kuvendit të Kosovës, e cila nuk është kuptuar si duhet, edhe më keq, është keqinterpretuar dhe kështu, si qëndron këtu në transkript, dëshiroj ta bëj korrigjimin.

Propozimi im kishte të bënte me Rezolutën, miratimin e Rezolutës serbe në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara. Duke e parë se Qeveria është neglizhente për këtë, unë kam shprehur shqetësimin, që Kuvendi i Kosovës ta hartojë një Rezolutë të vetën, me të cilën do të përcaktoheshin hapat e tjerë pas asaj ngjarjeje. Ky ka qenë, do të thotë, propozimi im. Meqenëse ju nuk ma keni dhënë fjalën për ta sqaruar, nuk është kuptuar si duhet, nuk është sqaruar dhe është keqinterpretuar, prandaj kërkoj korrigjimin e kësaj.

KRYETARI: Ju faleminderit shumë, po asnjë rezolutë nuk mund ta ketë fuqinë më të madhe se e ka Kushtetuta e Kosovës. Ju faleminderit!

Ndryshimet nëse duhet të bëhet në stenogram, në transkript, le të bëhen. Fjalën e ka kërkuar deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Unë vetëm desha të thirrëm në Ligjin mbi Fondin Pensional, të cilin ky Kuvend e ka miratuar më 13 qershor dhe është shpallur me dekretin e Presidentit më 15 qershor. Lexojeni shumë mirë, neni 6, përkatësisht nenin 2.2 që është zëvendësuar, ku flet për Grupin ndërmintor të punës dhe kompetencat që i ka karshi Fondit Pensional. Flas konform ndryshimit të Rregullores atje. Ju faleminderit! Do të thotë, kompetencat i ka të plota Qeveria.

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Të kisha lutur që, kur ta kalojmë pikën e rendit të ditës, të mos kthehemi prapa, ta bëjmë një kulturë parlamentare. Unë po kam mirëkuptim, po ua jap fjalën, por nuk është mirë ta keqpërdorni fjalën!

Fjalën e ka kërkuar deputeti Shkumbin Demalijaj.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Ju faleminderit, Kryetar!

E shoh si çështje të shkuar atë se votuam për të njëjtën çështje, mirëpo në këtë rast lidhur me rendin e ditës e shoh. Në takimin e Komisionit këto rekomandime kanë ardhur pas javës së kaluar, ndërkaq në Kuvend nuk diskutohet edhe për sigurinë në Kosovë.

Në këtë rast kisha pasur dëshirë, ashtu siç ngritën mocion Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për Rezolutën, edhe ne si Grup Parlamentar të ngrehim një mocion që në seancën e ardhshme të diskutohen dhe të organizohet debat lidhur me rekomandimet e Komisionit për Siguri, që presin që 3 muaj në Kuvend për të hyrë në rend dite, nuk hyjnë, ndërkaq hyjnë rekomandimet e javës së kaluar. Të shohim deri ku është çështja. Këtë kishim pasur dëshirë. Atë që e ka bërë Komisioni Parlamentar për Siguri dhe Punë të Brendshme. Kjo është kërkesa.

KRYETARI: Ju lutem, përsëri po e keqpërdorni fjalën që po ua jap. Kryesia e ka bërë rendin e ditës, kanë qenë shefat të grupeve parlamentare, edhe anëtarët e Kryesisë, që janë anëtarë të Komisionit dhe e dinë shumë mirë pse nuk ka hyrë në rend të ditës.

Siguria në Kosovë është shumë e mirë dhe për siguri në Kosovë dëshirojnë të flasin vetëm ata që e dëshirojnë këtë dhe mendoj që janë kundërshtarët e stabilitetit në Kosovë.

Nuk kisha dëshiruar të merrem me gjëra që nuk mendohen mirë.

Ne e kemi Qeverinë dhe kur kërkojmë nga Qeveria, atëherë mund të diskutojmë edhe për çështje të tjera.

Pra, tash vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës.  
A ka vërejtje në procesverbale? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 3 dhe 10 tetor.  
Faleminderit!

Pika e radhës është:

#### **- Koha për pyetje parlamentare**

Për shkak të numrit të madh të pyetjeve – 43, dhe kohës së kufizuar, propozoj që seanca të deklarohet për procedim vetëm të nga një pyetjeje të deputetëve, të atyre që kanë shtruar më shumë pyetje. Të shkojmë me rend.

Unë kisha thënë që kjo të bëhet praktikë, të mos votojmë për çdo seancë, por sot për këtë e kërkoj një votim formal.

A pajtoheni që secili deputet që ka bërë më shumë pyetje, ta lexojë vetëm një pyetje, e pastaj kur të kryhet kjo, vazhdojmë me pyetjen e dytë, e kështu me radhë.

Kush është për këtë propozim? Ju faleminderit!

Kush është kundër? Kam respekt!

A ka abstenime? Nuk ka.

Atëherë, me shumicën absolute, përkrahet propozimi që të lexohet vetëm nga një pyetje.  
Ju faleminderit.

Fillojmë me pyetjen e dytë, pasi që Hydajeti është tërhequr, kështu jemi të informuar.  
Vazhdojmë me pyetjen e dytë, deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.  
Deputete, urdhëroni, lexojeni pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Përfaqësuesi Special, zoti Zanieri, po bisedon me autoritetet në Beograd për çështje që janë shumë të rëndësishme për shtetin e Kosovës – çështjen e gjykatave, të policisë, të drejtësisë, të personave të pagjetur dhe për aktivitetet e Agjencisë Kosovare të Pronës.  
Kryeministër, pyetja ime është: A jeni ju të informuar për këto bisedime dhe kërkoj që ta informoni Kuvendin, nëse jeni në dijeni se për çfarë janë këto bisedime?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!  
E nderuara deputete Syla!

Roli dhe funksioni i autoriteteve të UNMIK-ut është i përcaktuar qartë. Ne e respektojmë dhe vlerësojmë rolin e OKB-së në këto nëntë vite. Mirëpo, edhe UNMIK-u është i vetëdijshëm se Kosova është shtet i pavarur, sovran dhe demokratik, se e ka Kushtetutën e vet. Roli i autoriteteve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara është kryesisht

lehtësues dhe, në kuadër të këtij roli, ata po zhvillojnë kontakte, kontakte të cilat janë në interes të paqes, të stabilitetit dhe të bashkëpunimit rajonal dhe të perspektivës për t'u integruar si shtete të veçanta në strukturat e Bashkimit Evropian dhe në NATO, Kosova si shtet dhe Serbia si shtet. Në emër të Kosovës, takime në përgjithësi për interesa të dy vendeve dhe të dy popujve tanë, kanë vetëm institucionet legjitime të zgjedhura nga populli i Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! Zonja deputete, a keni pyetje shtesë? E ka fjalën deputetja, Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Po, Kryeministër, unë isha shumë konkrete. Kërkoj që ta njoftoni Kuvendin se për çka flet Zanieri, sepse nga mediat po del se ju jeni të informuar. Çka po negocion Zanieri? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI: Po, realisht, unë jam i informuar për vizitat e zotit Zanieri në Beograd. Është i informuar edhe Kryetari i juaj dhe Presidenti, Kryetari i Parlamentit, kryetarët e të gjitha partive politike, grupet parlamentare. Ritheksoj: roli i UNMIK-ut është lehtësues dhe jo vendimmarrës. Për Kosovën, vendimin e ka marrë ky Kuvend, më 17 shkurt.

KRYETARI: Faleminderit shumë, zoti Kryeministër! Kalojmë në pyetjen e radhës. Deputetja Synavere Rysha, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Zoti Shala nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen? E ka fjalën deputetja Synavere Rysha.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, Kryetar!

Përsëritet, të nderuar kolegë deputetë dhe juve anëtarë të Kabinetit qeveritar, Unë pyetjen time e kam parashtruar, ka rreth një muaj, prandaj meqë sot ministri nuk është këtu, atëherë nëse Kryeministri do të përgjigjej, unë jam e gatshme ta bëj pyetjen, meqenëse ka të bëjë kjo edhe me Qeverinë.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me radhë. Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputet, mund ta lexoni pyetjen!

ARSIM REXHEPI: Zoti Kryeministër,

Sa keni qenë në opozitë, keni pas dhënë idenë për ndërtimin e një monumenti për Luftën e lavdishme të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi në Kosovë dhe e keni pas mbrojtur me shumë xheloz. Në ndërkohë, jeni në pozitë dhe Kryeministër. A jeni rikujtuar për ta vë në lëvizje një projekt të tillë? Faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI: Faleminderit, zoti deputet! Unë mendoj se pyetja juaj është parashtruar për projektin për ndërtimin e një përkujtimoreje në shenjë të respektit për Luftën çlirimtare të Kosovës dhe komandantit të saj Adem Jashari. Unë dua, përsëri, të

potencoj se personaliteti, figura dhe madhështia e komandantit legjendar Adem Jashari nuk duhet të ndahet në periudha dhe në relacione ndërpartiake. Është komandant legjendar i gjithë popullit të Kosovës, popullit shqiptar. Prandaj, ka obligim çdo qeveri, çdo parti, çdo qytetar për avancimin dhe ngritjen e atyre vlerave. Natyrisht, Qeveria e Kosovës do të punojë për avancimin e këtyre vlerave, jo vetëm me emërtime e lapidar, por si vlera për t'u avancuar, me të cilat do të krenohet çdo qytetar. Tanimë kemi shtatore dhe monumente të tilla edhe në Tiranë, edhe në Shkup. Shtatorja e komandantit legjendar, krejt natyrshëm dhe me legjitimitet të plotë institucional është duke u ngritur edhe në Kompleksin memorial në Prekaz, është fazë të kompletimit dhe do të jetë edhe në Prishtinë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë? Nuk ke! Faleminderit, edhe prej teje! Pyetja e radhës, deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputet, a doni ta lexoni pyetjen? Jo! Faleminderit!

Deputetja Nurishahe Hulaj, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta lexoni pyetjen!

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!  
Të nderur anëtarë të Kabinetit qeveritar dhe deputetë,

Çështja – Ligji për duhanin dhe zbatueshmëria. Ligji për duhanin numër 02 L/36 është aprovuar më 3.10.2005 dhe ka hyrë në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut 1/2007, 15 muaj me vonesë. Në bazë të nenit 11.2 të Ligjit për duhanin dhe të akteve të tjera në fuqi, Qeveria e mëparshme – Kryeministri, në bazë të Rregullores së Qeverisë, neni 4 pika 3, me Vendim numër 10/256 të datës 20.6.2007 ka themeluar Këshillin profesional për kontrollin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për duhanin.

Një ndër aktivitetet e Këshillit profesional për kontroll dhe mbikëqyrje të Ligjit për duhanin, është përgatitur edhe letra e përkushtimit për iniciimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për duhanin, letër e cila është dërguar te Kryeministri për nënshkrim dhe përkrahje të Këshillit profesional për kontroll dhe mbikëqyrje të Ligjit për duhanin.

Pyetja është: A do të nënshkruani letrën e përkushtimit lidhur me nevojën për iniciimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për duhanin sipas nenit 12 të Ligjit për duhanin, sepse me këtë qasje të gjitha ministratë do të kishin ndikim të rëndësishëm në zbatimin e Ligjit të cekur.

Anëtarët e Këshillit profesional për kontroll dhe mbikëqyrje të Ligjit për duhanin janë përfaqësues nga shumë ministri dhe anëtarë të organizatave me ndikim profesional e shkencor. Çështja për zbatimin e ligjeve, tani rregullohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 92, pika 3, neni 93, pika 4 dhe neni ....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI: E nderuara deputete, Hulaj,

Gjithsesi se jam i informuar, kam punuar dhe do ta nënshkruaj letrën e përkushtimit për zbatimin e Ligjit. Mirëpo, një gjë e tillë do të ndodhë edhe pas konsultimeve shtesë, që do t'i kem me Grupin punues, për të parë gjendjen se deri ku është arritur, prandaj kjo çështje është e realizueshme.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Jo! Faleminderit!

Deputeti, Riza Smaka, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputet Smaka, mund ta bëni pyetjen!

RIZA SMAKA: Të nderuar qeveritar, të nderuar deputetë,

Pyetja: Çështja problemore e referuar implementimit të dispozitës së nenit 283 të Ligjit Nr 02 L/70 për sigurinë e komunikacionit rrugor.

Nga disa raporte dhe deklarata zyrtare konstatohet se aksidenti në komunikacion rrugor shkaktohet nga disa defekte shëndetësore të shoferit – me certifikatë shëndetësore (SIK), pikërisht për defekte shëndetësore të shoferit të caktuar.

Së andejmi, mund të konkludohet se certifikata shëndetësore e shoferit në fjalë nuk korrespondon me gjendjen shëndetësore reale të tij. Rrjedhimisht, mund të konkludohet se certifikata shëndetësore e shoferit të tillë ka mund t'i jepet në kundërshtim me postulatet e dispozitës së nenit 283 të Ligjit të përmendur, në dëm të ligjësisë, e më pastaj të sigurisë në komunikacionin rrugor.

Zotëri ministër, me konsideratë ju pyes, nëse edhe ju ....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, urdhëroni, përgjigjuni!

MINISTRI ALUSH GASHI: Faleminderit shumë! Është një prej pyetjeve që ne na ka interesuar që nga fillimi i mandatit dhe mu për atë kemi kërkuar nga kryeinspektori i shëndetësisë së Republikës së Kosovës që ta bëjë një studim në të gjitha qendrat ku jepen certifikatat për vozitës. Dhe, gjatë atij procesi, është ardhur në përfundim se aty ka shumë lëshime. Inspektori ka qenë shumë aktiv dhe në më se 120 raste është dashur të shpall ndëshkime dhe, falë bashkëpunimit intensiv që tash e kanë me Ministrinë e Punëve të Brendshme – sektorin që merret me këtë çështje, shpresoj se kjo gjendje do të normalizohet.

Sa i përket pyetjes tuaj, shumë esenciale për gjendjen shëndetësore të të aksidentuarve, ne një hulumtim të tillë nuk e kemi, sepse gjatë regjistrimit të automjeteve, ata që e sigurojnë automjetin njëherë për njëherë s'e sigurojnë fare qytetarin dhe ne kemi një barrë shumë të rëndë financiare mjekimin e të aksidentuarve, ndërsa të dhëna statistikore

lidhur me këtë çështje nuk kemi sepse nuk e kemi sistemin e informimit shëndetësor në Republikën e Kosovës, si sistem të integruar. Kemi të dhëna të cilat mblidhen, por shpresoj se Kuvendi, në një të ardhme, ndoshta në buxhetin 2010 apo 2011 do të na ndajë mjete për të digjitalizuar sistemin. Sot nuk e kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a keni pyetje shtesë? E ka fjalën deputeti Smaka.

RIZA SMAKA: Do t'i kisha sugjeruar zotëri ministrit që këto çështje të hapura, që i tha këtu para nesh, t'i prezantojë edhe në Qeveri dhe Qeveria ka ingerenca që me akt juridik të përgjithshëm t'i përcaktojë normat e caktuara dhe ato të ekzekutohen në jetën praktike. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Koment, ishte ministër.

Deputeti Ibrahim Makolli, pyetje për ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi. Ibrahim, nuk qenka këtu. Vazhdojmë më tutje.

Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala. A doni ta lexoni pyetjen?

(Prej vendi – pa kyçje të mikrofonit)

Ne, votuam për nga një pyetje një herë.

Deputeti, Naim Maloku, pyetje për ministrin Fatmir Limaj. Nuk është këtu ministri. A doni ta bënin pyetjen, deputet?

(Prej vendi, pa kyçje të mikrofonit)

Mirë, faleminderit! Naim, a doni ta lexoni pyetjen? Urdhëroni! Fjalën e ka deputeti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Zoti Kryetar,

Unë kam ngritur shqetësimin për mundësinë ose jo të mbikëqyrjes së kualitetit të ndërtimit të rrugëve në Kosovë. Në qoftë se dikush prej Qeverisë jep përgjigje, atëherë unë e kisha bërë pyetjen, nëse jo, atëherë lus që të bartet për seancën e ardhës.

KRYETARI: Faleminderit! Këtë do ta lëmë deri atëherë, kur të vijë ministri dhe të jetë prezent.

Pyetja e radhës. Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputete, e keni fjalën!

LULJETA SHEHU: Faleminderit! I nderuari, Kryetar,  
I nderuar, Kryeministër,  
Të nderuar ministra,  
Të nderuar deputetë,

Meqenëse anëtarët e familjeve të personave të pagjetur marrin pension vetëm për një anëtar 130 euro, ndërsa për anëtarët tjerë të pagjetur nuk marrin, që do të thotë si për një të pagjetur, ashtu edhe për dy, gjashtë e më tutje të pagjetur, pensioni është i njëjtë.

Pyetja është: A do të ketë rritje pensioni, sipas anëtarëve të pagjetur të familjeve, sikurse që është rasti për familjet e dëshmorëve? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsjedniče,

Poštovani Premijeru,

Poštovani zamjenice premijera,

Kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Gospodo Šehu,

Bazirajući se na osnovu Zakona 02 L-2 o statusu i pravima porodica palih boraca, invalida, veterana i učesnika OVK i porodica civilnih žrtava rata, odnosno po članu 11. ovog zakona o pravima članova porodica civilnih žrtava rata ili nestalih tokom rata od 27.02.1998.godine do 20.06.1999. godine, ostvaruje samo jednu porodičnu penziju. Znači, prema navedenim odredbama ovog zakona, pravo ostvaruje samo za jednog člana penziju i ne predviđa nikakvo povećanje za ostale nestale članove. Što će reći da i pored onoga što smo mi želeli da imamo u 2009.godini povećanje i za porodice palih, ali jednostavno moramo da shvatimo da je naš budžet vrlo limitiran i bez obzira na svu našu želju da možemo da pomognemo u svim aspektima društva i da možemo svima da pomognemo, ipak, to je nerealno. Tako da, povećanja u ovom momentu nisu predviđena a i Zakon nas obavezuje da poštujemo ovo koje sad imamo. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a keni pyetje shitesë? Fjalën e ka deputetja Shehu.

LULJETA SHEHU: Zoti, ministër,

Familjarët e të pagjeturve këtë përgjigje e presin prej janarit të vitit 2008, sepse rritja është bërë vetëm për një anëtar, e shumica e familjeve kanë 4, 5, 6 e më shumë anëtarë të tillë. Prandaj, kur mund të pritet një rritje e tillë, në cilin vit dhe në çfarë periudhe mund të ketë ndonjë ndryshim.

KRYETARI: Përgjigja u dha, por megjithatë edhe një herë le ta marrë fjalën!

NENAD RAŠIĆ: Kao što sam već rekao, u 2009.godini, na žalost, nismo u mogućnosti da ostvarimo neko povećanje ali se nadam. Ja mogu da vam kažem najiskrenije da ćemo se zalagati da kao i u svim oblastima da to ostvarimo što pre. Ja stvarno ne mogu da vam kažem konkretan datum ili mesec ili godinu, ali sigurno da će to biti jedan od pravaca u kome će Ministarstvo da radi.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputetja Suzan Novobërdaliu, pyetje për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, mund ta bëni pyetjen!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, zotëri Kryetar!

Përsëritje për të gjithë,

Pronarit të Kompanisë “Hidrogjeni” i është dashur angazhim 3 vjet për ta kompletuar dokumentacionin për ndërtimin e dy hidrocentraleve të vogla në Kaçanik. Më 21 maj të këtij viti, ministri Mahir Yagcilar ka vënë gurthemelin për dy hidrocentrale buzë lumit Lepenc për ndërtimin e të cilave do të investoheshin 20 milionë euro. Sipas projektit, këto dy hidrocentrale do të fillonin prodhimin e energjisë pas 18 muajve. Paradoksi i gjithë kësaj është se vetëm një ditë pas vënies së gurthemelit, i ndërpritet puna Kompanisë “Hidrogjeni”. Prandaj, si ka mundësi që, pas përfundimit, respektivisht vënies së gurthemelit nga ana e ministrit të kabinetit tuaj, një ditë më pas, këtij investitori t’i ndërpritet puna. Gabim ishte që iu lejua, apo gabim ishte që iu ndërpre puna?

KRYETARI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Pasi që sot mungon ministri, unë do të flas në kuptimin e përgjithshëm për procesin si proces dhe jo për rastin konkret. Jam ithtar dhe jam i zotuar, kam edhe përgjegjësitë që të respektoj ligjshmërinë për të gjitha çështjet dhe unë dua të besoj se ministri ka respektuar Ligjin në fuqi, Ligjin në fuqi i cili do të respektohet për të gjitha rastet dhe çdo proces i tillë do të jetë transparent dhe me ligjshmëri fuqiplote.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! Deputete, a keni pyetje shtesë?

E ka fjalën deputetja Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Shembulli i Kaçanikut, a vlerësoni se është lajm i keq dhe frikësues për shkak të joseriozitetit të vendimmarrjes së Qeverisë për të gjithë ata investitorë të huaj apo vendor të cilët kapitalin e tyre donë ta investojnë në Kosovë.

KRYETARI: Zoti, Kryeministër!

KRYEMINISTRI: Unë mendoj se takoj çdo ditë investitorë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe prej prioriteteve kryesore të Qeverisë që udhëheq unë është thellimi i partneritetit me komunitetin e biznesit, por gjithmonë – respektimi i ligjit. Prandaj, respektimi i ligjit është alfa dhe omega e fillimit të punëve, avancimit të punëve, fuqizimit të angazhimeve tona të përbashkëta. Para çdo interesi tjetër, para çdo vullneti tjetër, unë kam obligim ta respektoj ligjin dhe do ta respektoj ligjin në përpikëri.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputetja Kaqusha Jashari, ka pasur pyetje për ministren Justina Pula, por nuk qenka këtu.

Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Ahmeti nuk qenka këtu. A doni ta lexoni pyetjen, deputet? Urdhëroni!

EMRUSH XHEMAJLI: Le të na jepet fjala lidhur me ministrat që janë këtu. Unë e kam pyetjen për ministrin Alush Gashi.

KRYETARI: Bëre pyetjen për ministrin Alush Gashi.

EMRUSH XHEMAJLI: Ajo pyetja tjetër ishte për këto tregjet financiare, por zoti Ahmet Shala mund të jetë në bursa, e ku të di unë, ku. Pra, unë po ia adresoj pyetjen ministrit që është këtu.

Kështu, është pyetje e shkurtër: I nderuari, zoti ministër, çka ka ndërmarrë Ministria që ju drejtoni për plotësimin e kërkesave të punonjësve të shëndetësisë, të cilët kanë paralajmëruar thirrjen e grevës për muajin tetor 2008. Kjo grevë është bërë, u tha se u ndal, përsëri ka probleme, do të dëshironim shpjegime lidhur me këtë.

KRYETARI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit! Që në fillim të mandatit, një prej prioriteve ka qenë përpjekja maksimale për një furnizim të qëndrueshëm me barna, si dhe përpjekja që me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të hartojmë një memorandum të mirëkuptimit për krijimin e të hyrave vetjake nga participimet dhe këto të hyra vetjake të përdoren për përmirësim të kushteve të punës dhe për stimulim. Dhe, pas shumë negociatave, ne kemi arritur që në maj të viti të nënshkruajmë një memorandum të mirëkuptimit me ministrin e Ekonomisë dhe të Financave dhe me atë memorandum participimi ka krijuar një sasi të mjeteve të cilat gjatë muajve të parë ua kemi dhënë njësive buxhetore që t'i përdorin për përmirësim të kushteve të vendeve të punës.

Inspektimet dhe anketat me qytetarë, por edhe nga zyrtarët e mjekësisë, kanë treguar se të hyrat vetanake dhe lejimi i harxhimit të tyre i kanë stimuluar punëtorët dhe ka filluar dukshëm përmirësimi i shërbimeve, gjë të cilën ne e dëgjojmë në deklaratat publike të qytetarëve të vendit tonë. Dhe, mu për atë kemi përgatitur si Ministri një plan që ta shikojmë mundësinë për të pasur një stimulim në mbështetje në ushqim, ekskluzivisht nga të hyrat vetanake pa e prekur buxhetin. Këtë e kemi ofruar dhe e kemi dhënë për shqyrtim në Ministri për Ekonomi e Financa dhe sindikata gjatë asaj kohe ka dalë me kërkesa të veta. Ne jemi shumë rigoroz në respektimin e udhëzimeve shumë rigjide të Fondit Monetar Ndërkombëtar sepse, si vend, synim e kemi anëtarësimin. Prandaj, Ministria e Shëndetësisë nuk ka kompetencë as mandat, as mjete për rritje të pagave. Ne kemi pasur këtë mundësi dhe kjo është pjesë e programi tonë, nuk është përgjigje në kërkesa. Kërkesat të cilat kanë dalë për hartim të ligjeve, janë kërkesa legjitime dhe në proces kemi formuar grupet, sindikata është pjesëmarrëse e atij procesi, kushtet e punës që iu takojnë me ligj, do t'i kenë, dhe unë besoj se me rregullimin e sistemit të pagave, të gjithë do të përfitojnë dhe, mbi të gjitha, do të përfundojnë punët si duhet.

KRYETARI: Me respekt për fjalën, ministër! A ka pyetje shtesë?

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj se me këtë çështje duhet më seriozisht të merret Ministria e Shëndetësisë. Këtu nuk u përmend diçka, që është shumë me rëndësi – Ligji i sigurimeve shëndetësore, për të cilin mendoj se Zyra Ligjore e Ministrisë dhe krejt mekanizmat duhet më shpejtë të punojnë që gjithçka të jetë në rregull në këtë aspekt dhe sa më shpejt të vihet në zbatim ky ligj.

Prej praktikave, që dihen, nuk ka mundësi që të bëhet ndryshe financimi i duhur i shëndetësisë së Kosovës dhe me këtë duhet të merremi të gjithë seriozisht.

KRYETARI: Ministër, urdhëro, mund të vazhdosh fjalën!

MINISTRI ALUSH GASHI: Unë mendova se një deputet dhe një artist si ju e kuptuat përgjigjen kur thash – kërkesat për legjislacion janë marrë me seriozitet, kemi formuar grupin punues, pjesë e grupit punues janë edhe ata vetë. Mirëpo, një çështje, dëshiroj ta kuptojmë të gjithë. Në Republikën e Kosovës për një qytetar, brenda një viti, buxheti ynë ia mundëson 42 euro. Për një Maqedoni janë diku 260 – 270 euro. Për një Mal të Zi, edhe më tepër. Kur të analizohen të dhënat e vitit 2008, sa janë harxhuar për shëndetësi, viti 2009 nuk do të ketë mjete më shumë. Prandaj, ne duhet të jemi shumë të sinqertë para qytetarëve. Ne nuk mund të themi se do t'i përmbushim kriteret e Fondit Monetar Ndërkombëtar, a të njëjtën kohë të kemi një përgjigje populliste që duhet të rritet rroga 200% ose 300%.

Unë, ju ftoj që, si Kuvend – deklaratën për mbështetje, urdhëroni krijomëni numrat! Keni të drejtë të më merrni në përgjegjësi sa herë doni, por kur të krijohet mbështetja financiare. Ne me këtë mbështetje, me këtë zhvillim ekonomik dhe me këto kriteret rigjide të Fondit Monetar Ndërkombëtar, duhet të jemi shumë të ndërgjegjshëm se nuk mund ta kemi. Ligjin për sigurime shëndetësore ne do ta kemi, por kur do të mundet ta zbatojë buxheti i Kosovës, është çështje e vendimit të Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit, për pyetjen!

KRYETARI: Faleminderit!

(Reagim, prej vendi pa kyçje të mikrofonit)

Jo, nuk ka replikë! Jo, jo. Ju lutem!

I nderuari deputet, respektojeni kohën, sepse atë e keni shfrytëzuar. Ju lutem!

Deputeti Driton Tali, i ka dy pyetje për Kryeministrin. Zgjidheni njëren prej tyre.

DRITON TALI: Po e kursej Kryeministrin. Do ta zgjidhja ministrin Rashiq në frymën e ditës së sotme, për Trustin e Pensioneve. E kam edhe atë pyetjen që ma huqe. Është edhe për Ahmet Shalën edhe për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, që ka të bëjë me Trustin, zoti Kryetar, dhe me lejen tënde, do ta bëja këtë pyetje.

Ka kohë që Trusti shënon rënie në vlerë për shkak të trazirave financiare. Edhe sa kohë duhet të presim derisa të ndërmerrni iniciativën për ndërrimin e Rregullores ekzistuese

dhe kur mund të presin edhe kontribuuesit, por edhe subjektet afariste dhe ekonomia në përgjithësi për këtë.

KRYETARI: Zoti ministër, a doni të përgjigjeni?

(Flet prej vendit, pa kyçje të mikrofonit, nuk dëgjohet)

Mirë, faleminderit! Do të thotë, nuk e ka marrë pyetjen. Atëherë, Driton, ti po duket, je i panafakë. E kreve! Faleminderit, Driton!

Deputeti Haredin Hyseni, pyetje për ministren Nekibe Kelmendi.

(Ndërhyrje, deputeti Driton Tali – pa kyçje)

Driton, do të vazhdojmë!

HARDIN HYSENI: Faleminderit, Kryetar!  
I nderuar Kryeministër, kabinet qeveritar,  
Deputetë të pranishëm,

Zonja ministre, në planin qeveritar për vitin 2008, ka qenë e paraparë që të hartohet Projektligji për personat e pagjetur, ku do të rregullohej statusi i tyre dhe kjo çështje do të trajtohej me ligj, sepse kjo kategori ende nuk zë një tretman të merituar.

Zonja ministre, a mund të na thoni se a kanë filluar procedurat për përpilimin e këtij projektligji dhe kur do të na sillni në Kuvend këtë projektligj.

KRYETARI: Zonja ministre, e keni fjalën!

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Zoti deputet, procedurat për hartimin e ligjit që e përmendët, kanë filluar, mirëpo ky është ligj shumë senzitiv dhe do një vëmendje dhe inkuadrim të një grupi të madh të ekspertëve. Ne jemi duke punuar në këtë ligj dhe unë pres që deri në fund të vitit të përfundojë ky ligj dhe do të bëjmë një ligj të mirë, për çka kemi inkuadruar edhe organizata ndërkombëtare.

KRYETARI: Faleminderit, ministre! Deputet, besoj, nuk ke pyetje shtesë?  
Faleminderit!

Deputetja Sanije Aliaj, pyetje për ministrin Sadri Ferati. Ministri, nuk është këtu. A doni ta bëni pyetjen, deputete?

SANIJE ALIAJ: Kërkoj t'i bëj pyetje ministres, zonjës Nekibe Kelmendi, në mungesë të ministrit tjetër.

KRYETARI: Po, mundesh! Urdhëro, vazhdoje fjalën, mos e ndërpre!

SANIJE ALIAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja ministre, Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione i janë adresuar në mënyrë të vazhdueshme një numër i madh i peticioneve, ku kryesisht objekt shqyrtimi kanë shkeljen e të drejtave të njeriut. Në mesin e tyre është edhe peticioni i ish të burgosurve politikë të Dubravës dhe peticioni i të burgosurve aktual.

Pyetja është, zonja ministre: Cilët janë hapat konkret të Ministrisë që e udhëhiqni ju, që të zvogëlohet numri i këtyre shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe a ka Ministria juaj raport pune dhe, nëse ka, ky raport t’iu jepet deputetëve në mënyrë që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministre, besoj se e keni marrë pyetjen dhe mund të përgjigjeni.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Unë mendoj se ka pasur disa shkelje të të drejtave të të burgosurve apo të të dënuarve dhe lidhur me to kemi pasur dy herë vërejtje nga organizatat humanitare. Të gjitha ato janë eliminuar dhe ne kemi raportin e gatshëm edhe përkitazi me mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe realizimin e të drejtave sipas standardeve më të larta. Kurse, sa i përket raportit, raporti është shumë voluminoz, unë jam në gjendje dhe mund ta sjell kur të doni për deputetët e Parlamentit, për ndonjë seancë tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a keni pyetje shtesë?

SANIJE ALIAJ: Faleminderit për përgjigjen! Nuk kam pyetje shtesë. E presim raportin.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Shkumbin Demalijaj, pyetje për Kryeministrin Thaçi. Deputet, mund ta bëni pyetjen!

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Sinqerisht, kërkoj falje, mirëpo kursenani sa të mundeni nga retorika dhe komentet pasi ta përfundojmë fjalën, sepse po dalim joserioz para publikut kur po thoni se “po e keqpërdorni foltoren”. Edhe një herë, po kërkoj falje që po duhet të lëshohem në këtë, por besoj se po flasim për çka obligon ligji dhe Rregullorja e Kuvendit dhe nuk jemi jashtë kornizës. Po shkoj direkt në pyetjen.

Zoti Kryeministër, që nga fillimi i privatizimit të ndërmarrjeve të ndryshme shoqërore dhe deri tani, janë grumbulluar 481 milion euro.

Ju, zoti Kryeministër, gjatë fushatës tuaj elektorale keni deklaruar se shumë shpejt do ta ktheni atë kapital financiar në Kosovë në qoftë se arrini ta merrni pushtetin.

Zoti Kryeministër, cilat janë veprimet konkrete që ju dhe Qeveria juaj keni ndërmarrë që t’i ktheni këto mjete në Kosovë?

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti deputet!

Qeveria, përmes ministrive të linjës, gjithashtu Bankës Qendrore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Privatizimit në Kosovë, është duke punuar me ritëm të lartë që të sigurojë një zgjidhje të qëndrueshme dhe ligjore për kthimin e fondeve të investuara jashtë Kosovës dhe atë, duke nënkuptuar, së pari:

Duke krijuar kornizën ligjore me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe emërimin e Bordit të AKP-së;

Përpilimin e draftit për Ligjin mbi borxhet shtetërore dhe garancitë shtetërore, i cili ka për qëllim t'i ofrojë Republikës së Kosovës autoritetin për të huazuar para dhe për të dhënë garanci për hua.

Në këto ligje definohej edhe procedurat e lëshimit të letrave me vlerë të Qeverisë, përmes të cilave do të krijohen parakushtet dhe mundësitë më të mëdha, që një pjesë e madhe e mjeteve të kthehen dhe të investohen, apo të gjitha shumë shpejtë në Kosovë.

Intensifikimin e punës për pagesën e mjeteve 20% për punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara dhe ky proces veç ka filluar.

Pastaj funksionalizimin e Gjykatës speciale për shqyrtimin e rasteve që lidhen me kërkesat e ankesat gjatë procesit të privatizimit.

Pastaj, monitorimin e vazhdueshëm të performancës, krahas rrezikut në sektorin bankar. Pra, ky proces ka filluar dhe do të vazhdojë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, keni pyetje shtesë?

SHKUMBIN DEMALIJAJ: Zoti, Kryeministër, a e dini se ku janë të investuara këto mjete dhe a ka rrezik që t'iu nënshtrohen humbjeve nga kriza financiare në botë?

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI: I gjithë procesi ka qenë fare transparent me opinione të cilat kanë qenë të prezantuara nga shumica e njerëzve në Kosovë, bartësve të institucioneve, të partive politike dhe të gjithë atyre njerëzve përgjegjës që kanë qenë të involvuar në këtë proces, edhe vendor, edhe ndërkombëtar, por më e rëndësishmja është që ky proces i kthimit të këtyre mjeteve ka filluar dhe kjo është punë, rezultat i kësaj pune 5-6 mujore.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Deputetja Drita Maliqi, pyetje për ministrin Arsim Bajrami. Deputete, e ke fjalën!

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Pse nuk po bëhet ndryshimi i politikave ekzistuese në stimulimin e shërbyesve civilë nëse dëshirojmë të kemi një administratë profesionale, funksionale dhe efikase, për shembull, rritjen e pagave, të themi, apo edhe pagesën e shujtave. Në kuadër të kësaj, kam paraparë që t'ju pyes – edhe sa po ju largohen ekspertët e lëmive të ndryshme nga institucionet për shkak të mosstimulimit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara deputete, zonja Maliqi,

Dëshiroj t'ju njoftoj se Qeveria po i qaset në mënyrë shumë komplekse dhe parimore çështjes së rregullimit të shërbimit civil dhe çështjes së pagave në Republikën e Kosovës dhe në kësaj çështjeje po i qasemi me një pako legislative, e cila këto ditë do të diskutohet në Qeveri dhe shumë shpejt do t'i prezantohet edhe Parlamentit.

Unë do të prezantoj elementet e kësaj pakoje dhe risitë që parashohin këto elemente.

Fillimisht, ne jemi në përfundimisht të sistemit të ri të reformuar të pagave, jemi në finalizim të Ligjit për pagat dhe ne shpresojmë se ky ligj do të miratohet gjatë këtij muaji në Qeveri dhe pastaj të vijë në Parlament. Ky ligj ka për qëllim të vendosë një disiplinë financiare, një rend sa u përket pagave në tërë sektorin publik, qoftë në sektorin e administratës publike, qoftë në pjesën e të emëruarve politikë, sepse Qeveria ka trashëguar një sistem kaotik të pagesave dhe në këtë çështje jemi duke e rregulluar në mënyrë sistimore, jemi duke bërë nomenklaturën e pagave, duke filluar nga paga më e lartë në Republikë e deri te paga më e ulët në shërbimin civil. Është një sistem modern evropian i pagave, është punuar me partnerë ndërkombëtarë dhe ne jemi duke e finalizuar Ligjin për pagat.

Dokumenti i dytë, apo projekti i dytë që Qeveria e Republikës së Kosovës është duke e finalizuar është Projektligji për shërbimin civil. Një Projektligj që iu ka dashur Kosovës dhe ne jemi duke e finalizuar këtë projektligj. Ky Projektligj, në fakt do të vendosë rend në shërbimin civil duke identifikuar qartë se ç'është shërbimi civil, kategoritë e shërbimit civil dhe ky ligj do të ndërlidhet domosdoshmërisht edhe me Ligjin për pagat.

Gjithashtu, jemi duke punuar edhe segmente tjera të përmirësimit të pozitës materiale të shërbyesve civilë. Në fakt, Qeveria, javën e kaluar ka miratuar Udhëzimin administrativ për stimulimin e kuadrove deficitare që punojnë në teknologjinë informative dhe ka vendosur që këto kuadro të stimulohen me paga shtesë për t'u mbrojtur edhe nga konkurrenca e kompanive private, të cilat janë të pranishme në tregun kosovar të teknologjisë informative. Ne kemi identifikuar numrin e këtyre ekspertëve që sillet rreth 200 ekspertë në nivel të Kosovës dhe kemi akorduar pagesa dinjitoze shtesë që ata të motivohen për të punuar në sektorin publik.

Po ashtu, jemi duke punuar edhe në masa të tjera. Jemi duke e diskutuar edhe çështjen e mundësisë së pagesës të një pagese për të gjithë shërbyesit civil në formë të shujtës, jeni duke biseduar, duke i krahasuar edhe praktikën tjera evropiane. Kemi finalizuar edhe

projektin për një transport të mundshëm të shërbyesve civilë në formë të organizuar me subvencione të caktuara dhe jemi në implementim të orarit të ri të punës.

Dëshiroj t'ju bind se të gjitha këto masa po diskutohen në mënyrë serioze. Nuk janë shumë të ndikuara nga presionet e sindikatave, por janë një pjesë e strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës që kjo çështje nga 1 janar të fillojë të implementohet. Është një materie shumë e rëndësishme për të vendosur një disiplinë financiare. Gjithmonë, Qeveria e Republikës së Kosovës ka parasysh faktin se Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore janë duke diskutuar me Qeverinë e Kosovës Kornizën buxhetore të vitit 2009 dhe ne kemi aplikuar për anëtarësim dhe jemi jashtëzakonisht të interesuar që këto masa të jenë shumë të kujdesshme, shumë të arsyeshme dhe të ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputete, a ke pyetje shtesë? Urdhëro, e ke fjalën!

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti ministër! Me të vërtetë, thatë shumë se jeni duke u angazhuar. Na vjen shumë mirë, por mendoj kjo çështje që është mjaft e rëndësishme për të gjithë stimulimin e kuadrove deficitare e, kuptohet, edhe profesioniste. Kur, saktësisht, zoti ministër, nuk na thatë. Domethënë, kur do të bëhet kjo saktësisht? Na jepni një datë të saktë apo të përafërt, sepse e cekët edhe ju, është në planin zhvillimor apo në strategjinë e juaj, që e keni cekur shumë edhe gjatë fushatës zgjedhore. Domethënë, mendoj që të na përgjigjeni rreth kësaj. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, mund të vazhdosh përgjigjen, ministër!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Deputete Maliqi, sa për informatën tuaj, dëshiroj t'ju përkujtoj se asnjëherë gjatë këtij viti nuk ka pushuar kompensimi për kuadrot deficitare, për kuadrot që punojnë në teknologjinë informative, por pas një studimi, Qeveria e Kosovës ka vendosur që këtu të vendosë një rregull dhe javën e kaluar ka miratuar Udhëzimin administrativ ku vendosen kompensime të njëjta për të gjithë ekspertët e teknologjisë informative. Gjithashtu, me Ministrinë e Financave jemi të angazhuar që të punojmë bashkë edhe për kategori të tjera të shërbyesve civilë që janë deficitare dhe që ushtrojnë punë me interes të veçantë për Republikën. Pra, kjo është duke u realizuar. Që nga ky muaj këta kanë marrë shtesa dhe në fakt ne me këtë po mbrojmë edhe sektorin publik të teknologjisë informative nga konkurrenca që sfidohet me sektorin privat.

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja, Teuta Hadri, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputete, a do ta lexosh pyetjen? Urdhëro, lexoje! Fjalën e ka deputetja Teutë Hadri. A e ke kartelën?

TEUTA HADRI: Faleminderit!

Në pagat e punëtorëve shëndetësorë për punën e kujdestarisë iu ka ndalë tatimi 20% që nga viti 2003. Me këtë ndalesë është bërë gabim, këtë e ka pranuar edhe Ministria e Financave, të mandatit të kaluar, se është ndalesë e gabueshme.

Pyetja: Pse, zoti ministër, edhe ju nuk i ktheni përsëri këto pagesa që i keni ndal gabim?

KRYETARI: A do të përgjigjet ministri i Shëndetësisë? Urdhëro, ministër!

MINISTRI ALUSH GASHI: Ju faleminderit!

Kjo është një prej çështjeve, të cilat i kemi diskutuar gjatë pjesës së parë të këtij viti dhe një numri të atyre punëtorëve organizatat buxhetore iu kanë siguruar vërtetime dhe ekzekutimi i saj ka filluar. Shpresoj se këto ditë do të funksionalizohet softueri i burimeve njerëzore dhe do të jetë shumë më lehtë dhe më shpejt që ato vërtetime t'iu jepen të gjithëve dhe të ekzekutohen nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Pra, kjo do të rregullohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Nuk ke. Faleminderit!

Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin Idriz Vehapi. Idrizi nuk është këtu. A ke pyetje tjetër, ndoshta për ministrin e Arsimit? A doni ta lexoni pyetjen? Jo! Faleminderit!

Po vazhdojmë radhazi. Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin, zotin Thaçi. Deputete, mund ta bësh pyetjen!

GJYLNAZE SYLA: Një problem me rëndësi për shtetin e Kosovës, edhe pas shpalljes së pavarësisë, ngel çështja e integritetit të komunitetit serb në Veri. Përgjegjësia e parë për zgjidhjen e këtij problemi bie mbi Qeverinë e Kosovës.

Kryeministër, ju pyes: A ka Qeveria e Republikës së Kosovës strategji për integrim – plan operacional, duke përfshirë edhe aspektin kohor.

KRYETARI: Kryeministri, qenka i përgatitur, kështu që mirë është!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Natyrisht se jam i përgatitur! Për këtë punë edhe jam në Parlament që t'iu përgjigjem deputetëve. Faleminderit, zoti Kryetar!

E nderuara deputete Syla,

Ne kemi shpallur Kosovën shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, duke respektuar integritetin territorial të saj, të njohur dhe të pranuar edhe ndërkombëtarisht. Si Kryeministër i Kosovës kam themeluar menjëherë Zyrën e veçantë për komunitete që më raporton direkt mua dhe punoj drejtpërdrejt me ta. Gjithashtu, është Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisë shtetërore të Presidentit të Kosovës është themeluar edhe Këshilli konsultativ i komuniteteve. Por, Kosova është një, unike dhe funksionon si tërësi, bashkërisht duke punuar për funksionalizimin e të gjitha institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, duke respektuar rikonfigurimin aktiv.

Nuk dëshiroj që t'i ndaj qytetarët në baza etnike të Kosovës, në shqiptarë, serbë, turq, boshnjakë, hashkalij apo të tjerë. Përkushtimi im, dhe i Qeverisë së Kosovës, është i barabartë për të gjithë. Por, do të mbetesha borb, ndoshta, sikur të mos përgjigjesha,

sepse kam edhe letrën e kryetarit të Partisë suaj që ka kërkuar që t'i ndahen nga 5000 euro çdo qytetari serb. Unë, nuk e kam atë mundësi! Nëse i llogarisim ato mjete, janë rrafsh sa buxheti i Republikës së Kosovës. Unë kam obligim para 2 milion qytetarëve dhe ndaj gjithë territorit të vendit, e jo vetëm ndaj një komuniteti. Prandaj, kjo është përgjigja ime.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! Deputete, a ke pyetje shtesë?  
Fjalën e ka deputetja Sylja.

GJYLNAZE SYLA: Kryeministër, është e qartë që ti nuk ke asnjë plan. Kryetari i Partisë sime, së paku e ka një plan.

Çështja është se nuk jeni të informuar, si duket, se çka po ngjanë atje. Në qoftë se mendoni se ashtu zgjidhet problemi, ju kujtoj çfarë më keni thënë në seancën e 29 korrikut 2008 për formimin e agjencionit, gjegjësisht të drejtorit. Keni thënë se vendimet do të merren në ditët e ardhshme. Meqenëse nuk e dini se çka ngjanë, unë ju ftoj që sa më shpejt ta kryeni obligimin që e keni dhe premtimin që e keni dhënë se drejtori i agjencionit do të zgjidhet brenda ditëve të ardhshme, dhe kjo është më 29 korrik 2008.

Unë pyeta, cilat masa konkrete politike, ekonomike? Problemi është aty, nuk e keni zgjidhur.

KRYETARI: Urdhëroni, Kryeministër!

KRYEMINISTRI: E nderuara dhe e respektuar deputete Sylja, gjërat i ngatërrove pak në pjesën e dytë.

Plani im del nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe jo nga logjika e ndarjes së qytetarëve në baza etnike. E theksoj, plani juaj është ndarja e nga 5000 eurove për qytetarët serbë të veriut. Unë kam obligim për 2 milionë qytetarë të Republikës së Kosovës dhe plani juaj është ndarja e këtyre mjeteve, që është rrafsh sa buxheti i Republikës së Kosovës. Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen e kryeministrit, ngrite çështjen në Parlament, Parlamenti le të debatojë, unë jam i gatshëm që çdo përgjegjësi dhe çdo vendim të Parlamentit të Kosovës ta implementoj. Por, unë funksionoj me logjikën e ligjit, të Kushtetutës dhe jo të projekteve private – vetëm për një entitet. E theksoj, plani juaj kushton hiq më pak se buxheti i konsoliduar i Kosovës. Unë kam obligim para 2 milionë qytetarëve. Ju uroj për iniciativën tuaj dhe e mirëpres ta diskutojmë të gjithë së bashku.

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër! Kjo ishte pyetja dhe përgjigja e fundit për këtë seancë.

Unë dua ta them një çështje, për të mos komentuar dhe, vërtet, kam marrë vendim që të mos i komentoj fjalët e deputetëve, por i kisha lutur deputetët që ta respektojnë rendin e ditës.

Tani do të shkojmë në një pauzë, e cila do të zgjasë deri në orën 15,30. Pra, në orën 15,30 vazhdojmë punën.

### **Vazhdimi i seancës pas pauze**

KRYETARI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën.

Në rend të ditës me radhë është pika e tretë:

#### **- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për masat antidamping**

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministrin për Tregti dhe Industri, zotin Lutfi Zharku, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar Kryetar,  
Të nderuar ministra, ministre,  
Të nderuar deputetë,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushëveprimin dhe përmbajtjen e Projektligjit për masat antidamping, rolin dhe rëndësinë që ka për sistemin e gjithëmbarshtëm ekonomik të Kosovës.

Aktualisht nuk kemi ligj që rregullon fushëveprimtarinë e Antidampingut, pra kemi një fushë të parregulluar me ndonjë akt ligjor apo mekanizma dhe instrumente të tjera. Arsyeja për këtë Projektligj qëndron në faktin se me këtë ligj përcakton rregullat për procedurat, kushtet e përcaktimit dhe të zbatimit të masave antidamping dhe kundërbalancuese me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe prodhimit vendor në rastet kur dëshmohet dhe pengohet nga praktikatat jolojale të tregtisë ndërkombëtare përmes importeve të dampuara ose të subvencionuara.

Projektligji vendos një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore në përputhshmëri me normat dhe direktivat sipas Organizatës Botërore të Tregtisë si dhe me praktikatat dhe legjislacionin e Unionit Evropian dhe vendeve anëtare të saj.

Gjatë hartimit të Projektligji janë konsultuar direktivat e OBT-së, si dhe praktikatat e vendeve të BE-së duke pasur parasysh edhe direktivën 384/96 mbi mbrojtjen kundër importeve të dampuara nga vendet joanëtare të BE-së me ndryshimet e fundit të kryera gjatë vitit 2005.

Struktura e Projektligjit përmban 11 kapituj:

Dispozitat e përgjithshme përcaktojnë dampingun si masë e cila zbatohet për produktet që janë objekt i dampingut, importimi i të cilave në tregun e Republikën e Kosovës shkakton

ose kërcënon t'i shkaktojë dëm industrisë për të vazhduar më tutje me përcaktimin e subvencionimit si masë kundër balancuese.

Në kreun e IV të Ligjit shtjellohet vlerësimi i dëmtimit të shkaktuar nga dampingu ose subvencioni, përcaktimi i këtij dëmi me rastin e importeve të dampuara ose të subvencionuara dhe jo vetëm kur i shkaktohet drejtpërdrejt dëm industrisë vendase, por edhe kur e ngadalëson zhvillimin ose pengon krijimin e kësaj industrie.

Me rastin e vlerësimit të dëmit të shkaktuar nga dampingu ose subvencioni, përkatësisht përcaktimin e këtij dëmi, Ligji në kreun V përcakton mekanizmin përmes të cilit themelohet Komisioni për vlerësimin e masave për importet e dampuara ose të subvencionuara.

Dispozitat e përfshira në Kreun VI, mbi fillimin e hetimeve, përmbledhin kushtet dhe kriteret për fillimin e hetimeve, si dhe njoftimin dhe kohëzgjatjen e hetimeve deri në vendimin përfundimtar, për të vazhduar më pastaj me Kreun mbi aplikimin dhe mbledhjen e masave antidamping, mbledhjen, kohëzgjatjen, rishikimin dhe rimbursimin.

Me synimin që shteti i Kosovës në një të ardhme të afërt të anëtarësohet në OBT, e cila është e vetmja organizatë ndërkombëtare që merret me përcaktimin e rregullave të funksionimit të tregtisë ndërmjet vendeve anëtare, duke pasur parasysh rëndësinë që paraqet ky ligj për Republikën e Kosovës në lëmin e ekonomisë dhe të tregtisë, në përgjithësi, si dhe me qëllim të mbrojtjes së industrisë dhe të prodhimit vendor, në veçanti, rekomandojmë që Projektligjit për masat antidamping, pas shqyrtimit të miratohet dhe të dërgohet në procedim të mëtejshëm. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Sipas radhës, kryetarja e Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Përshëndetje, Kabinet qeveritar,

Ne, në mbledhjen e kaluar kemi shqyrtuar Projektligjin për masat antidamping. Komisioni ka marrë këtë vlerësim se Projektligjin për masat antidamping përcakton rregullat dhe procedurat, kushtet për përcaktimin dhe zbatimin e masave antidamping dhe kundër balancues me qëllim të mbrojtjes së bizneseve nga konkurrenca jolojale, gjatë tregtimit ndërkombëtar përmes importeve të subvencionit.

Komisioni vlerëson se ky Projektligj në mënyrë të detajizuar sanksionon dhe krijon mundësi për avancimin, afarizmin në përgjithësi, duke mbrojtur bizneset nga praktika jolojale afariste, duke mbështetur konkurrencën e lirë dhe të barabartë në treg, nxitjen e eksportit, investimet si dhe përmirësimin e bilancit, në përgjithësi, si rezultat i shkëmbimeve tregtare.

Komisioni vlerëson se Projektligji në përgjithësi i plotëson kërkesat për standardizimin juridiko - teknik dhe gjuhësor. Bazuar në këto përfundime, Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion e mbështet, në parim, Projektligjin për masat antidamping dhe propozon që Ligji të procedohet për shqyrtim dhe amendamentim në komisionet përkatëse. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Sipas radhës, shefi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja, apo deputetja Sala Berisha – Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA – SHALA: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Duke ju përshëndetur, do të përpiqem të kursej kohën. Projektligjin në fjalë e kemi analizuar me vëmendje, si Grup Parlamentar, andaj në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës e mbështesim, në parim. Kontributin tonë do ta japim në Komisionin Parlamentar gjatë fazës së amendimit të këtij Ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet Ligjin në lexim të parë dhe do të marrë pjesë në procedurat e mëtejme të leximit dhe të amendimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka kërkuar fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,  
Të nderuar qeveritarë dhe deputetë,

Përderisa së pakut njëri nga shtetet fqinje të Republikës së Kosovës nëpërmjet subvencionimit të çmimeve të prodhimeve bujqësore dhe jo vetëm bujqësore, garantimit të realizimit dhe të grumbullimit të tyre, në një anë, dhe të stimulimit të shitjes përkatësisht të shitjes direkte të tyre në Kosovë, me çmime dukshëm më të ulëta nga çmimet e prodhimit, në anën tjetër, edhe ashtu produktet dhe mallrat respektive kosovare disfavorizohen fillimisht nga prodhimi, rrjedhimisht edhe nga realizimi, dëmtohet rëndë prodhimi dhe qarkullimi i prodhimeve dhe i mallrave kosovare dhe në përgjithësi dëmtohet ekonomia e tregut me kompeticionin e lirshëm në Kosovë.

Së andejmi, Projektligji për antidampingun është i mirëseardhur, andaj parimisht ky Projektligj mbështetet nga Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re me kusht që gjatë procedimit, deri na adoptim, të përmirësohet dukshëm si në përmbajtje, ashtu edhe në formë. Rrjedhimisht, të prezantohen disa nga vërejtjet parimore me synim të kontribuimit në favor të përmirësimit dhe të begatimit përmbajtësor të këtij dokumenti:

1. Tekstet e Projektligjit për masat antidamping në shqip, serbisht, boshnjakisht dhe anglisht do të duhej të harmonizoheshin reciprokisht nga se dispozita të tëra, e të mos flitet për paragrafe, aktualisht nuk janë në koherencë formale dhe materiale.

2. Terma të caktuar në këtë dokument juridik, pos që nuk janë të harmonizuara reciprokisht në tri gjuhët, por në raste të caktuara janë përdorë në forma inadequate, siç mund të shërbente rasti nga neni 2 i tij, ku në gjuhën shqipe, serbishte boshnjakishte në vend të shprehjes antisubvencionim, aty dhe më tej është përdorë termi “kundërbalances”, përkatësisht “antibalansirajući”. Ndryshe, fjala “subside” në anglisht ka domethënie të uljes, të zbritjes, të qetësimit, të plotësimit, e herë - herë të dytësorës, ndërsa në kontekstin konkret, kurdoherë të kuptimit antisubvencionim.

3. Nenin 2 të këtij projektligji për masat antidamping në kontestin e shpjegimit të kuptimit, e më pastaj në rrjedhën e dispozitave ligjore, është definuar termi konkurrencë lojale, joleale, i cili do të duhej të zëvendësohej me fjalën kompeticion, sepse nocioni i konkurrencës konsiston në të kundërtën e kompeticionit, si rrjedhë e përbashkët, ndërsa në rastin konkret përmban konotacion të kundërt.

4. Paragrafi 1 i nenit 9 të Projektligjit, nëse është përkthyer nga anglishtja, është përkthyer keq dhe, se andejmi, edhe kuptimi i kundërt me të, sepse si përkthim adekuat, në vend të diksionit të tanishëm “marzha e dampingut është përqindje me të cilën vlera reale është më e madhe se çmimi i eksportit”, do të duhej thënë: “marzha damping është përqindje nga e cila vlera normale është dukshëm më e madhe nga çmimi eksportues”. Fjala është se në këtë mënyrë jepet kuptimi i kundërt i dampingut edhe i antidampingut.

Për shprehjen “vlerësim” në shqip, në paragrafin 1 të nenit 24 të Projektligjit, në anglisht nuk do të duhej aplikuar shprehja review, e cila përkon më tepër me “recenzionimin”, por termi evaluate ose estimate, e rrjedhimisht në serbisht apo boshnjakisht termi aktual inadequate, ku thuhet “razmatranje”, do të duhej të thuhej “ocenivanje! apo, eventualisht, “utvrđivanje”.

Në nenin 46 konfidencialiteti do të duhej zëvendësuar me termin adekuat “sekret”, i cili mund të jetë sekret zyrtar i të tri shkallëve, varësisht nga rasti në rast. Projektligji lëndor do të duhej t’i përmbante edhe dispozitat ndëshkimore dhe nenet e tija në funksion të praktikitetit dhe do të duhej të rikonfiguroheshin me më pak paragrafe. Janë nenet shumë të gjata, që nuk janë praktike as për lexim, as për interpretim.

Përfundimisht, me shpresë se këto dhe tjera defekte në këtë dokument juridik gjatë procedimit të mëtejshëm do të evitoheshin në funksion të përmirësimit cilësor, këtë Projektligj e mbështesim në këtë etapë procedurore dhe më lejoni që të propozoj se në kontestin e këtij dokumenti shkojnë edhe tri dokumente tjera ligjore, Ligji antimonopon, Ligji antitrust dhe Ligji antidamping janë në konotacion reciprok të ndërlidhur që nuk mund të aplikohen me efikasitet po që se edhe ato dy të tjerat nuk do të miratoheshin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Realisht, një fjalë të cilën e tha parafolësi i përgjigjet shumë asaj çka po bëjmë, ishte fjala “Ligji është i mirëseardhur”.

Realisht, ekzakt e shpjegon krejt atë çka po bëjmë ne. Ligji nuk është i domosdoshëm, nuk e shpëton Kosovën prej kush e di se çfarë situatë në të cilën është, por është i mirëseardhur, mirë boll që e kemi, do me thënë kjo është esenca e krejt kësaj çka kemi. Disa pyetje duhet të shtrohen kur vjen një ligj ose kur Qeveria propozon miratimin e një ligji nga Kuvendi i Kosovës. Huhet të ketë një studim paraprak. Cila është situata sot, çka kemi pasur gjatë 10 viteve, për shembull ta marrim të cilat kanë kaluar, a kemi pasur probleme serioze me këtë fenomen dhe a parashihet, në fund të fundit, që në të ardhmen të kemi probleme të këtij lloji në mënyrë që të përgatitemi paraprakisht për ta miratuar një ligj dhe për t’u mbrojtur.

Ne tani jemi mësuar të dëgjojmë prej ministrave se sa paragrafe i ka ligji, kush ka punuar në ligj, e tjera, e tjera gjëra të cilat ne i lexojmë, por nuk po dëgjojmë dikush si sponzorues i ligjit të na thotë cilat janë arsyet politike dhe një përgjigje politike pse ky ligj, një përgjigje efektive se çfarë situatë kemi ne, çfarë situatë na ka detyruar që ta miratojmë një ligj të tillë. Nuk po dëgjojmë diçka kësi soji asnjëherë, nuk është rasti i parë, mirëpo vetëm po e ngreh si fenomen. Kjo do të thotë që dikush po i propozon ligjin dhe dikush po thotë, ahu, ide e mirë, hajt se po e bëjmë edhe një ligj kështu se e kanë edhe vendet e tjera. Edhe nëse ka studim, deputetëve nuk po iu ofrohet ky studim. Ato që po na ofrohen neve, janë aspekte administrative. Përdorimin ministrat janë të zgjedhur dhe të emëruar politik, ata duhet të na shpjegojnë politikisht pse ligji, çka po na duhet ky ligj, cilat janë situatat, mos ta përsëris vetveten, edhe si kemi ardhur.

Çështja tjetër që është tepër e rëndësishme është ajo që po na vjen prej Ministrisë së Financave dhe që është prapë në vazhdimësi, nuk është hera e parë. Nëse e shikoni raportin për implikimet buxhetore, tregohet për shpenzimet që i shkakton ky ligj, mirëpo ato janë shpenzime administrative, janë shpenzime tipike administrative të sakta, të llogaritshme. Mirëpo, nëse dikush dëshiron të ketë koncept të qartë çka po flasim ne për ligjin, çka është ligji, çfarë implikimesh politike ka, çka është politikisht ky ligj, atëherë edhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të ketë njerëz të cilët punojnë politikisht dhe na tregojnë cilat mund të jenë implikime buxhetore nëse vijmë në një situatë të cilën duhet intervenuar në bazë të këtij ligji ose a parashihet në moment i cili kish për të qenë i vështirë, do të thotë, për shkak se nuk po thuhet këtu se ky është raport për shpenzimet buxhetore, por thotë është raport për implikime buxhetore, do të thotë mund të ketë implikime pozitive. Cilët janë skenarët e mundshëm, krejt ajo që duam të them ne se është po, do ta mbështesim ligjin në parim. Mirëpo po kërkojmë që kur bëhen këto analiza të cilat na afrohen neve, të na tregojë dikush cilët janë skenarët, në mënyrë që deputetët e Kuvendit të Kosovës të dinë që në rast se e votojmë këtë ligj, cilat do të mund të jenë implikimet e mundshme për Kosovën, cilat do të jenë situatat e mundshme për Kosovën në bazë të të cilave ne mund të vendosim se a është i dëshirueshëm apo jo. Ne e kemi studiuar ligjin, mendojmë se është i dëshirueshëm, mirëpo mendojmë se

shumë pakë punë po bëhet nga ana e Qeverisë për ta sofistikuar vetveten në aspektin e prezantimit të ligjeve para Kuvendit të Kosovës. Është një format i para 10 viteve edhe nëse kemi një Qeveri e cila premtonte sofistikim të vazhdueshëm, le të fillojë prej letrave të cilat na i sjell para nesh në Kuvend. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, Synavere Rysa e ka fjalën, besoj që e kuptoni që është fjala për mbështetjen në parim të Projektligjit.

SYNAVER RYSHA: Faleminderit, Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, pas shqyrtimit të Projektligjit për masat antidamping vlerëson se është i nevojshëm dhe është i mirëseardhur për qytetarët e Kosovës dhe për bizneset e Kosovës, prandaj në parim do ta përkrahim këtë Projektligj dhe vërejtjet tona do t'i japim përmes përfaqësuesit tonë në komisionin funksional, të gjitha ato vërejtje që do t'i kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” deputeti Xhezair Murati, e ka kërkuar fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Dosvolite da vas pozdravim i vas, i ministre i kolege,

Nacrt zakona o merama protiv dampainga spada o one zakone koji uređuju jednu oblast, ja bih rekao, kod nas vrlo malo ili uolšte neuređivanu zakonom. Ovaj Nacrt zakona pozajmljen i nedovoljno vešto prenet od hrvatskog, to svako ko prati dakle svu dokumentaciju koja nam je dostavljena, može odmah na startu da uoči, tako da bi trebalo malo da honorisemo i one koji su dali ovaj zakon, ne samo našu radnu grupu.

Ovaj zakon ima za cilj poboljšanje uslova za preduzetništvo, ali i zaštitu domaćih proizvođača, kao i borbu protiv nelojalne konkurencije, sive ekonomije i tako dalje. On je u stvari podsticaj za izvoz, ali i smanjivanje tržišnog deblansa, mi već znamo kakav je.

Značajan je u toliko više što nemamo druge zakone i zakonske akte i mehanizme i ovoj oblasti, mada je jedan od prethodnih govornika, profesor Riza, rekao najbliže zakone koju ovu oblast regulišu.

Po običaju, radnoj grupi koja je radila na njemu, opet ću samo da ponovim kao i mnogo puta ranije, da opet nema predstavnika ili eksperata iz drugih zajednica. Tekst je dosta nejasan uz puno jezičkih, ali i materijalnih grešaka. Ukoliko ne bude sve to otklonjeno u daljoj proceduri, Parlamentarna Grupa „7+“ će na osnovu toga tek odlučiti da li ćemo ga podržati ili ne. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, deputetja Radmila Vujović

RADMILA VUJOVIĆ: Uvažena gospodo,

Parlamentarna grupa SLS u načelu podržava Nacrt zakona o antidamping merama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Të nderuar deputetë, tani kërkohet deklarimi për miratimin, në parim, të Projektligjit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Në sallë kemi 70 deputetë.

Konstatohet se me 68 vota “për”, “kundër” nuk ka, abstenim nuk ka, Kuvendi miratoi Projektligjin për Masat antidamping.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ngarkohen këto komisione.

1. Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, si komision funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Buxhet dhe Financa,
3. Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
4. Komisioni për Komunitete, dhe
5. Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet, brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, duhet Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Pika e radhës:

**- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural**

Ministri mungon, andaj ne po kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, pasi që pikën 5 e kemi tërhequr në fillim të seancës.

Pika e radhës është pika e gjashtë e rendit të ditës:

**- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka vlerësuar se Projektligji dhe amendamentet e propozuara kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Ligjit dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete ka vlerësuar se Ligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Integrime Evropiane ka vlerësuar se dispozitat e Ligjit dhe amendamentet e propozuara nuk bien ndesh me parimet bazë të *acquis communautaire*.

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komisionit funksional dhe raportues, ka bërë shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nr. 02/L-5 dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, nëse e sheh të nevojshme për të arsyetuar raportin me rekomandime.

Në emër të Komisionit, fjala i jepet deputetes Safete Hadërgjonaj.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritarë,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion dhe Transport e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe ka dhënë rekomandimet e veta që në këtë seancë të miratohen.

Mirëpo, unë dua ta bëj një njoftim në lidhje me këtë Projektligj për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, sepse ky Projektligj do të ishte miratuar që në muajin prill të këtij viti sikur stafi mbështetës i Komisionit t'i kishte përfshirë të gjitha ato amendamente të cilat janë miratuar në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Telekomunikacion. Kështu që, raporti i dalë nga stafi mbështetës, me datën 15 prill 2008, nuk ka përfshirë atë çka është miratuar në Komision, çka është amendamentuar në Komision, kështu që është dashur në Komisionin për Buxhet raporti të kthehet prapë dhe të plotësohet.

Unë nuk dua të paragjykoj nëse stafi mbështetës i Komisionit nuk ka ditur të hartojë raportin, duke marrë për bazë Projektligjin për plotësim ndryshime, Ligjin për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe tani ta hartojë raportin, apo nuk ka dashur t'i bëjë këto përmirësime, por ne jemi të detyruar disa herë të mbajmë mbledhje të Komisionit, të cilat nuk kanë qenë mbledhje të lehta për të ardhur deri te ky raport përfundimtar. Si rezultat i kësaj, janë 6 raporte të hartuara nga stafi mbështetës i Komisionit, të cilat raporte asnjëri me tjetrin nuk përshtaten.

Si përfundim, pas gjithë këtyre problemeve me të cilat jemi përballur me stafin mbështetës, e kemi raportin e fundit të cilin ne e kemi përpara dhe komisioni funksional është i mendimit që ky raport të kalojë, por njëkohësisht të merren parasysh edhe vërejtjet

e Komisionit për Buxhet e Financa që ky raport të harmonizohet nga Zyra për Standardizim dhe Harmonizim, t'i rregullojë disa referenca sipas teknikës së hartimit të amendamenteve. Do të thotë, është e nevojshme që disa referenca të plotësohen nga ana e Zyrës për Standardizim. Kështu, mendojmë që ne si Komision e kemi kryer punën tonë dhe mbetet të votohen.

**KRYESUESI EQREM KRYESIU:** Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, në vazhdim procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve sipas radhës së paraqitur në raportin e komisionit funksional.

Shkojmë me amendamentin 1.

Regjia gati, deputetët gati, votojmë tash:

Ju faleminderit!

Konstatoj se me 53 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Regjia gati, deputetë gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Regjia dhe deputetë gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 4 abstenime, 0 “kundër”, miratohet edhe amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Bëhuni bati për të votuar amendamentin 4. Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 58 “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Bëhemi gati për amendamentin numër 5. Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 4 abstenime dhe 0 “kundër”, miratohet edhe amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 7 abstenime dhe 0 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Bëhemi gati për amendamentin numër 7.

Regjia dhe deputetët bëhen gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 61 vota për”, 5 abstenime dhe 0 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Regjia dhe deputetët, gati për votim, votojmë tash:

Konstatoj se me 57 vota “për”, 4 abstenime dhe 0 “kundër”, miratohet amendamenti nr. 8.

Amendamenti 9.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, 4 abstenime dhe 0 “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Bëhemi gati për amendamentin 10. Regjia, deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti nr. 10.

Amendamenti 11.

Regjia gati, deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Ju njoftoj se në sallë janë 69 deputetë, që do të thotë se kuorumi është për të marrë vendime fuqiplota.

Amendamenti 12.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 4 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti numër 12.

Amendamenti 13.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 4 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti numër 13.

Amendamenti 14.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet edhe amendamentit i fundit.

Të nderuar deputetë, procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve sipas radhitjes së paraqitur në raportin e komisionit funksional dhe të tekstit të Ligjit në tërësi.

Regjia gati, deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 5 abstenime dhe 2 vota “kundër”, miratohet Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Ju faleminderit!

Dhe, po shkojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

#### **- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Noterinë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë parashtruar rekomandimet e tyre.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka vlerësuar se dispozitat e Ligjit dhe amendamentet e propozuara nuk kanë implikime buxhetore.

Komisioni për Komunitete gjithashtu ka vlerësuar se Ligji dhe amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional, ka vlerësuar se Projektligji për Noterinë ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe njëherësh i ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve të propozuara, ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit funksional, Bahri Hysenin, mundësisht, nëse e sheh të nevojshme për të arsyetuar raportin me rekomandime.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!  
Përshëndetje të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me rregullën 35.4, 36 dhe 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, pas dëgjimit publik që ka organizuar për Ligjin për Noterinë me datë 25 mars, në takimin e tij të rregullt, dhe më 8 korrik 2008 shqyrtoi Projektligjin për Noterinë dhe Kuvendit të Kosovës i ofron këtë raport.

Projektligji për Noterinë do të ofrojë zgjidhje praktike për të gjitha çështjet jokontestimore që kryhen nga gjykata komunale, që kanë natyrë të ngjashme me shërbimet që ofron Noteria.

Nevoja për këtë Ligj është e pakontestueshme, sepse Kosova po kalon në një ekonomi të tregut të lirë, ku edhe rregullat juridike për zgjidhjen e çështjeve kontestuese duhet t'ju përshtaten rrethanave të krijuara.

Komisioni ka vlerësuar se dispozitat e Projektligji për Noterinë do të ofrojnë një kornizë ligjore shumë praktike dhe efektive për kryerjen e shërbimeve për qytetarët e Kosovës dhe është konstatuar se dispozitat e këtij Projektligji e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Kosovës.

Komisioni, gjatë shqyrtimit ka marrë në konsiderim edhe raportin nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe deklarata është që nuk ka implikime buxhetore.

Nga Komisioni për Komunitete ka pranuar një rekomandim, ku Komisioni për Komunitete ka paraparë që në këtë Projektligj të jetë edhe një amendament që fjala “javno beležnistvo“ të përdoret në tërë tekstin e Projektligjit dhe në titullin e Projektligjit. Komisioni nuk e ka marrë përsipër këtë amendament dhe nuk e ka vendosur, nuk e ka renditur si amendament, sepse Komisioni ka konsideruar se ky amendament është pa bazë, sepse në tërë Projektligjin, në gjuhën serbe ekziston fjala “javno beležnistvo“, por Komisioni ka rënë në huti me rastin e leximit të raportit, ku është përkthyer nga Zyra për

përkthim, dhe nuk iu kanë përmbajtur Projektligjit ekzistues. Prandaj, konsiderojmë që është amendament i panevojshëm sepse ekziston në Projektligj.

Duke marrë parasysh rëndësinë që ka ky Projektligj, sugjerojmë që deputetët e Kuvendit të Kosovës ta aprovojnë Projektligjin në fjalë me amendamentet e propozuara. Faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni!

Atëherë, në vazhdim procedojmë me votimin dhe miratimin e amendamenteve sipas radhitjes së paraqitur nga komisioni funksional.

Amendamenti 1.

Regjia, deputetë gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 0 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Regjia, deputetë gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Regjia, deputetë gati, Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti numër 3.

Amendamenti 4.

Regjia, deputetë gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti numër 4.

Amendamenti 5.

Regjia dhe deputetë gati. Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Regjia dhe deputetë të bëhen gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti numër 6.

Amendamenti 7.

Regjia dhe deputetë gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Regjia dhe deputetë gati, votojmë tash:

Jemi në proces të votimit, por po e bëjmë një përjashtim. Po kërkoj falje prej të tjerëve, urdhëro Sabri!

SABRI HAMITI: Zotëri kryesues, nuk është përjashtim, po kjo është rregull strikte. Para se të votohet, çdo nen mund të diskutohet, mund të hedhet, mund të votohet ose të mos votohet.

Meqë unë nga pak i lexoj këto farë nenesh që propozohen, te neni 8, neni 8 s'ka substanciale kurgjë, po ka përpjekje për përmirësim gjuhësor. Unë ju them që edhe variantet që janë dhënë, janë shumë të pa konkorduara gjuhësisht. Unë e kuptoj që janë munduar ta përmirësojnë gjuhësisht, por s'kanë arritur, sepse kjo që thotë: "nuk mund ta marrin detyrën", këta i thonë: "detyra e noterit nuk mund ta kryejnë", po nëse shkohet ... edhe niset prej dyshit, fjalia e parë te tjetra, prapë ka problem se ka filluar procedura e ndjekjes penale, nuk ka kuptim me lidhjen përpara, nëse nuk thuhet: "ata ndaj të cilëve" e tjera, ka filluar kjo. Unë e bëra këtë vërejtje që ata që e kryejnë redaktimin sintaktik dhe provojnë, atëherë le ta bëjnë si duhet. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Hamiti!

Amendamentet janë afruar, unë s'mund t'i ndërroj, veç nëse doni t'i kthejmë edhe njëherë.

(Reagime në sallë)

Unë po ju lus, mos të zgjohet apetiti për të folur shumë. Kur Qeveria ndërhyrë, atëherë ne të tjerët pushojmë. Urdhëro, po mirë, në cilën cilësi të duash. Zonja Nekibe, ministrja e ka fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Deputetja!

KRYESUESI: Deputetja, zonja Nekibe.

NEKIBE KELMENDI: Këtu, kur thuhet, zëvendësohet me fjalinë: "detyrën e noterit nuk mund ta kryejnë", duhet të jetë: "profesionin e noterit nuk mund ta ushtrojnë", kështu do të ishte e drejtë.

KRYESUESI: Më lejoni që t'ia jap fjalën zotëri Hysenit, kryetar i Komisionit.

BAHRI HYSENI: Zotëri Kryesues,  
Faleminderit shumë!

Natyrisht që redaktura mund të bëhet dhe ajo nuk është përgjegjësi e Komisionit. Kurse propozimet që munden dhe nuk munden t'ju përshtaten, këto nuk janë çështje përmbajtësore. Ne tash mund t'i gjejmë 20 fjali, mirëpo diçka përmbajtësore nuk janë duke propozua. Prandaj, kërkoj që të procedohet sipas amendamentit të propozuar.

KRYESUESI: Shikoni, unë po propozoj që ta qesim në propozim këtë të komisionit funksional dhe, në qoftë se kalon, mirë, në qoftë se nuk kalon, në rregull.

Shkojmë te amendamenti numër 8, siç është i propozuar në tekst.  
Regjia dhe deputetët të bëhen gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 45 vota “për”, 7 abstenime, 4 vota “kundër”, miratohet amendamenti numër 8.

Amendamenti 9.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 50 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 11.

T’ju përkujtoj se gjithnjë e kemi kuorumin me 71 anëtarë të pranishëm këtu të Parlamentit.

Amendamenti 12.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 0 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 60 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Zonja Nekibe Kelmendi e ka kërkuar fjalën.

MINISTRJA NEKIBE KELMENDI: Te teksti i betimit: “me sjelljen profesionale dhe në çdo kohë sjellje profesionale” diçka është e papërshtatshme për këtë ligj, por do të duhej të thuhej “me profesionalizëm”, nëse pajtohet Bahriu. Unë, për mendimin tim, “me profesionalizëm”, do të thotë: “me Kodin e etikës noteriale me profesionalizëm dhe në çdo kohë do t’i mbrojmë interesat e palëve”

KRYESUESI: Faleminderit, deputete!  
E konsultojmë kryetarin e Komisionit, zotëri Hysenin.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryesues!  
Sponzoruesi i ligjit ka qenë Ministria e Drejtësisë dhe është mirë të shihet se si e ka propozuar në projektligj. Ne vetëm e kemi amendamentuar dhe e kemi bërë pak ma mirë seç është në Projektligj. Shikoni në Projektligj: “dhe sjelljen profesionale”. Ministria e Drejtësisë dhe nga Ministria e Drejtësisë është përcjellë Projektligji. Prandaj, propozoj të mbetet si në amendamentin e propozuar.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!  
Do t’i votojmë amendamentet e propozuara këtu.

Amendamenti 17.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 53 vota “për”, 6 abstenime, 4 “kundër”, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 60 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 56 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 59 vota “për”, 0 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 abstenim, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 21.

Ju lutem, kur doni ta merrni fjalën, shtypeni tasterin, përndryshe është e vërtetë se unë po e shfrytëzoj kohën tuaj, po e kursej, po e shfrytëzoj dhe po e kursej. Në qoftë se ju keni kohë me bollëk, edhe mua nuk më bëhet vonë shumë dhe dalëngadalë shkojmë.

Amendamenti 22.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 42 vota “për”, 2 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.  
Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:  
Konstatohet se me 61 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti i parafundit 30.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti i fundit, 31.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 64 vota “për”, 2 abstenime, 0 “kundër”, miratohet amendamenti i fundit, 31.

Lus tani deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim të tekstit të Projektligjit në tërësi, me amendamentet e posa miratuara. Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, 3 abstenime, 0 “kundër”, miratohet Projektligji me amendamentet e miratuara më parë. Ju faleminderit!

Shkojmë te pika tjetër e rendit të ditës:

- **Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për gjendjen në pyjet e Kosovës**

Në bazë të përfundimit të seancës plenare të mbajtur më 10 tetor 2008, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka bërë plotësimin e

rekomandimeve lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës dhe i ka propozuar Kuvendit që t'i miratojë.

Teksti i rekomandimeve u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Kërkojmë nga zotëri Lulzim Zeneli që të thotë fjalën e vet në mbështetje të këtyre rekomandimeve.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pas debatit që kemi pasur me datën 10 tetor, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar edhe njëherë rekomandimet duke u bazuar në debatin që është zhvilluar në seancën e fundit dhe i rekomandon seancës plenare, për miratim, këto rekomandime.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim të ndërpresë përkohësisht të gjitha aktivitetet legale që ndërlidhen me prerjen e pyjeve në Kosovë, veçanërisht në Komunën e Deçanit. Kjo përfshin edhe anulimin e tenderit për prerjen e drunjve.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural urgjentisht të përgatisë planin menaxhues afatgjatë për pyjet e Kosovës.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyje, në pajtim me politikat e Qeverisë së Kosovës.

4. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta iniciojë procedurën për rristrukturimin e Njesisë së Rojeve të Pyjeve, në përputhje me nevojën dhe gjendjen e krijuar në Kosovë.

5. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta fillojë procedurën për krijimin e lehtësirave doganore për importuesit potencial të drurit.

6. Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të kërkojë nga gjykatat që shqyrtimi i lëndëve që ndërlidhen me dëmtimin e pyjeve në Kosovë të ketë prioritet.

Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Zeneli!

Ju përkujtoj se në sallë janë të pranishëm 76 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë që të bëhen gati t'i votojnë këto rekomandime. Votojmë, tash.

Rekomandimet miratohen me 59 vota “për”, 3 abstenime dhe 1 “kundër”. Ju faleminderit! Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës- pikën e nëntë, sepse të dhjetën nominalisht e kemi hequr.

**Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Raportin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionin e brendshëm.**

Vërejtje hyrëse:

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar Raportin e grupit të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/L-74 për revizionimin e brendshëm dhe ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet në seancë plenare.

Raporti i grupit të punës dhe rekomandimi i Komisionit u janë shpërndarë deputetëve. Me këtë rast, më lejoni që ta ftoj kryetarin e Komisionit funksional, zotin Gani Koci, që ta arsyetojë Raportin.

Zoti Koci, e keni fjalën.

**GANI KOCI:** Ju faleminderit, zoti kryesues!

Pasi që kemi të bëjmë me një raport rreth implementimit të Ligjit, të një ligji mjaft të rëndësishëm, Ligjit për auditimin e brendshëm dhe meqë ky ligj ka të bëjë me shumë me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, konsideroj se është më se e domosdoshme që të jetë i pranishëm ministri i Ekonomisë dhe i Financave gjatë shqyrtimit të këtij raporti. Nëse detyrimisht ne duhet ta shqyrtojmë sot edhe në mungesë të ministrit, paraprakisht duhet ta falënderoj grupin punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ka qenë i udhëhequr nga zoti Armend Zemaj, sepse ka kryer një punë në mirë, duke inspektuar shumë agjenci buxhetore dhe duke ardhur deri te konstatimet se si është zbatuar ky ligj.

Në këtë rast, dua ta falënderoj edhe NDI nga e cila kemi pasur një mbështetje dhe konsiderojmë se është bërë një punë e mirë nga ky Komision. Lidhur me këtë raport do t'ia kisha dhënë fjalën Armend Zemajt, meqë edhe pse tash nuk është momentalisht anëtar i Komisionit për Buxhet, në emër të punës që ka kryer, ai do të duhej të raportojë për këtë. Mirëpo, në radhë të parë kërkoj një deklaram që vërtet duhet të jetë i pranishëm ministri i Ekonomisë dhe i Financave. Gjithashtu, do të duhej të ishin të pranishëm Kryeministri dhe zëvendëskryeministrat dhe ministrat tjerë që kanë të bëjnë me të gjitha dikasteret ministror, ku në shumicën prej tyre është bërë ky inspektim i implementimit të këtij ligji. Ne nuk duhet t'i flasim vetvetes, sepse këto që janë gjetur dhe shkruar në raport, kanë të bëjnë pikërisht me ata që mbikëqyrin dhe e zbatojnë këtë ligj.

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Koci!

Meqë ju shprehet një farë lloj mëdyshje, atëherë detyrimisht e sipas radhës duhet t'ua jap fjalën shefave të grupeve. I pari, e ka fjalën zoti Ramë Buja.

**RAMË BUJA:** Zoti kryesues, unë besoj, që siç e tha edhe Ganiu, ne nuk mund t'i flasim vetvetes, ngase shqyrtimi i këtyre rekomandimeve ka të bëjë drejtpërsëdrejti me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, kështu Pra, pa prezencën e të tjerëve nuk di çfarë të flasim, prandaj, në emër të Grupit Parlamentar propozoj që të shtyhet për një seancë tjetër.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Buja!

Fjalën e ka zoti Sabri Hamiti, në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike.

SABRI HAMITI: Natyrisht që e mbështesim shtyrjen e trajtimit të kësaj problematike, por unë sugjeroj që të jetë në mbledhjen e ardhshme dhe të mos hyjë as në mbledhjen e ardhshme, pa qenë me marrëveshje të detyrueshme që ministri i resorit të jetë këtu. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hamiti!

Fjalën e ka zoti Shkumbin Demaliaj, në emër të AKR-së.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe ne si Grup parlamentar, por edhe vetë si anëtar i Komisionit, propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të shqyrtohet për seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Demaliaj!

Fjalën e ka zoti Ardian Gjini në emër të AAK-së.

Zoti Gjini, e keni fjalën!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Ne do të abstenojmë prej votimi në cilindo variant, për shkak se është pika e katërt e rendit të ditës që sot hiqet nga diskutimi, domethënë e eliminojmë. Nuk është diçka që duhet të vazhdojë të ndodhë. Pra, është praktikë e keqe që jemi duke e përsëritur në vazhdimësi dhe të gjitha këto ndodhin vetëm për shkak se nuk ka koordinim paraprak të dy partive në pushtet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini!

Në emër të LDD-së e ka fjalën, Berim Ramosaj.

BERIM RAMOSAJ: Vërtet shqetëson rasti i mungesës së ministrit për Financa, sepse shkalla e implementimit të ligjeve, jo vetëm e këtij ligji, por e shumicës së ligjeve në Kosovë, nga realiteti objektiv shihet se është shumë e ulët. Domethënë krejt këto ligje që po i miratojmë ne, shkalla e implementimit të tyre është e ulët, e një rekomandim i tillë është më se i nevojshëm për Qeverinë, në mënyrë që të shihet deri në çfarë shkalle po implementohet ligji, andaj edhe ne e përkrahim shtyrjen e këtij debati, respektivisht, miratimin e këtyre rekomandimeve, pa prezencën e faktorit ekzekutiv. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ramosaj!

Zotëri Xhezair Murati në emër të Grupit” 7+”.

DŽEZAIR MURATI: I mi se pridružujemo šefovima parlamentarnih grupa da se ova tačka dnevog reda odloži kada bude prisutan resorni ministar. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati!

Në emër të Grupit SLS, zoti Dragiša Miriq.

DRAGIŠA MIRIĆ: Hvala, gospodine predjedavajući. Podržavamo da se ova tačka dnevnog reda odloži za sledeću sednicu.

KRYESUESI: Ministri, e ka fjalën!

MINISTRI FEHMI MUJOTA : Ju faleminderit, zoti kryesues!

Sigurisht që kryetari i Komisionit me të drejtë ka kërkuar që të ketë shtyrje të kësaj pike të rendit të ditës, meqë kërkohet që të jetë ministri i pranishëm, por për hir të publikut dhe të seancës, themi se ministri është jashtë vendit në udhëtim zyrtar, prandaj për këtë çështje kemi mirëkuptim të plotë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Mujota!

Tani do të votojmë formalisht për shtyrje ose jo të këtij debati.

Kush është për shtyrjen e këtij debati?

Ju faleminderit!

Kush është kundër? A abstenon kush? Me 4 vota abstenim dhe këta të tjerët janë për shtyrje, domethënë miratohet shtyrja e kësaj pike për një seancë tjetër. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës që është:

**11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për zbritjen e tarifës menaxhuese.**

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar kërkesën dhe propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për zbritjen e tarifës menaxhuese dhe Kuvendit ia ka paraqitur rekomandimin e vet.

Kërkesa e Trustit dhe Rekomandimi i Komisionit u është shpërndarë tashmë deputetëve dhe e ftoj edhe një herë tjetër, zotin Gani Koci që ta marrë fjalën.

GANI KOCI: Pas diskutimeve rreth Bordit të Trustit Pensional, në pikën 10, më duket që kjo ka më shumë të bëjë me këtë pikë, që ne veç e shtyjme, megjithatë, unë në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, duke pasur parasysh gjithë angazhimet e anëtarëve të Komisionit, në atë mbledhje që kemi diskutuar lidhur me këtë kërkesë, duke pasur para vetes edhe dy njerëz kompetent të Trustit Pensional, me të cilët jemi ballafaquar gati dy orë dhe të gjithë kemi qenë të pajtimit në atë komision që kjo kërkesë për ulje të tarifës nga 0.9% të bjerë në 0.8% për vitin 2009. dhe se kjo është miratuar në Komision.

Lidhur me arsyetimin e kemi përshkrimin dhe kërkesën e Trustit Pensional, kështu që unë nuk do të lëshohem në te absolutisht dhe natyrisht, lidhur me kërkesën e kemi edhe bazën ligjore mbi të cilat Trusti Pensional është mbështetur që ka kërkuar këtë zbritje të

tarifës, prandaj, në emër të Komisionit kërkoj që të miratohet këtu në Kuvend kërkesa e tyre.

Sa për diskutimet që u dëgjuan edhe më herët, se do të duhej një analizë, do të duhej një raport, po e përsëris edhe një herë se raport prej Trustit Pensional nuk do të kemi përderisa nuk e kemi bordin e konsoliduar të këtij trusti.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Koci! Fjalën do t'ua japim kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Zoti Buja, e ka fjalën.

RAMË BUJA: Ne si Grup Parlamentar do të votojmë “ për”.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zoti Sabri Hamiti!

SABRI HAMITI: Këtu kemi një mënyrë dyshe të arsytetimeve, kemi arsyetimet logjike dhe arsyetimet politike. Natyrisht që ne do të votojmë, mirëpo ajo që është thënë në këtë foltore edhe sot paradite, edhe tash le të dihet se edhe kryetari i Komisionit gjegjës është dashur që ta shpjegojë këtu. Ky 09 e që është bërë 08, kujt i referohet, çfarë shume i referohet, çka prodhon kjo, për çka harxhohet dhe për kënd harxhohet? Le të mbeten pyetjet e hapura para Kuvendit të Kosovës, se pa një informim çka po ndodh në këtë Trust, këtë shifër 0.9 që bëhet 0.8 pa referenca, kujt i referohen, kjo është gjysmake. Kaq!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hamiti!

Kalojmë te AKR-ja, zoti Shkumbin apo zoti Riza, cili doni ta merrni fjalën në emër të grupit?

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar, por edhe si anëtar i Komisionit, ne e kemi shqyrtuar në Komision për zbritjen e tarifës menaxhuese të Trustit Pensional. Është e vërtetë se ne nuk kemi asnjë raport, por kjo është pakujdesia e mekanizmave ekzekutiv të pushtetit të Republikës së Kosovës, sepse i vetmi vend ku konkurset e hapura zgjasin prej 1 vit e 2 muaj edhe 6 muaj, është Kosova edhe gjithçka është shkelje e ligjshmërisë në këtë rast dhe duhet të presim edhe një seancë plenare për ta shqyrtuar zbatimin dhe miratimin e formimit të Bordit drejtues të Trustit Pensional.

Ne nuk kemi asnjë shumë dhe nuk besoj se as ju vetë si Qeveri nuk dini, pra, askush nuk din cila është vlera e Trustit Pensional deri me tash dhe nuk dimë cilën tarifë duhet për ta zvogëluar apo për ta rritur? Në këtë rast, me qenë se është folur nga ata pjesëtarë që sot punojnë në Trustin Pensional të Kosovës, është kjo tarifë, ky trajtim bëhet për uljen e tarifës menaxhuese dhe ndikon pozitivisht në Buxhetin e Kosovës, ne në Komision e kemi hartuar një definicion që të ndikojmë pozitivisht te Buxheti i Kosovës që të ulet kjo tarifë menaxhuese, mirëpo s'kemi raport, as ne si Grup Parlamentar dhe as grupet tjera parlamentare dhe besoj se duhet të shtyhet gjer në themelimin e Bordit ekzekutiv të Trustit Pensional.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Demaliaj!

Kalojmë te Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Gjini do ta marrë fjalën në emër të Grupit Parlamentar.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit dhe një herë zoti kryesues!

Është e njëjta çështje, është pika e pestë e rendit të ditës, që po pretendohet të hiqet. Po pyes sa kohë kemi humbur në fillim të seancës duke diskutuar se cilat pika duhet të mbesin dhe cilat pika duhet të hiqen dhe sa kohë po humbim tani për pikat e rendit të ditës të cilat nuk i shqyrtojmë?

Çështja tjetër është ajo që, në pjesën e parë të kësaj seance e ka përmendur deputeti Tali dhe tani e përmendi edhe parafolësi- se nuk po marrim material i cili kishte për të na bërë që ne si deputetë të ndihemi të sigurt se çka po votojmë. Janë materiale të kamufluara. Një përqindje që del këtu e paarsyetuar, jo vetëm si shumë e mjeteve monetare për shkak se ajo përqindje paraqet mjete monetare në esencë, mirëpo asnjë arsyetim pse ndodh kështu, cilat janë arsytet pse ne vijmë deri te ky pozicion kësisoj? Ne prapë nuk do ta votojmë as këtë mocion, por nuk do ta votojmë as propozimin që një gjë e tillë të kalojë kur edhe do të vijë në seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYEUESI: Ju faleminderit, zoti Gjini!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, zonja Synavere.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë në fakt e mbështet dhe e përkrah propozimin e uljes së tarifës menaxhuese për Trustin Pensional të Kosovës, mirëpo forma se si na ka ardhur në Kuvend dhe se si është servuar në këtë Kuvend, është e papranueshme.

Ne nuk kemi elementet bazë për të ardhur deri te kjo tarifë sa është e arsyeshme. Ndoshta në start kjo tarifë prej 0.8 duhet të ulet edhe më poshtë. Ky është vetëm një fakt kur kemi parasysh sa i ka të ardhurat drejtori i Trustit Pensional të Kosovës, por janë edhe shumë fakte tjera që duhet debatuar dhe duhet të kërkohet nga Trusti Pensional i Kosovës- operacionet tjera apo forma se si operon dhe si i menaxhon këto mjete për të ardhur ai deri te një tarifë? Nuk e di sa është e qëllueshme, sa është e pranueshme dhe sa është e arsyeshme kjo tarifë, prandaj në fakt ne nuk e përkrahim dhe kërkojmë argumente shtesë për këtë çështje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Rysha!

Grupi Parlamentar “7+”, zoti Xhezair Murati.

DŽEZAIR MURATI: Mi, takodje mislimo da treba još stručnih pojašnjenja oko smanjenja ove tarife. Zaista, svi nismo ekonomisti i trebaju ove stvari razjasniti ovde pred ovim telom, a potom čemo se izjasniti. Dakle zahtevamo jedno pojašnjenje i od ekonomista, i od samog ministarstva, ali i od Komisije koja će sigurno povodom ovoga ponovo Resorna Komisija... Znači mi čemo se naknadno o tome izjasniti. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Murati!  
Nga Grupi SLS- e ka fjalën zonja Radmilla.

RADMILA VUJOVIĆ: I mi zahtevamo dodatna objašnjenja ili pojašnjenja kako hoćete. Hvala!

KRYESUESI: Unë, unë po e marr guximin që ta pyes Parlamentin - a ta hedhim në votim për ta sponuar këtë nga rendi i ditës a jo, sepse disa nga shefat e grupeve ishin... Rekomandimi i Komisionit është e vërtetë që ka qenë që të shqyrtohet sot në rend dite, dhe meqë jemi pak a shumë të pasigurt, atëherë duhet të mbështetemi te Komisioni, nuk kemi çka të bëjmë. Zoti Koci dëshiron ta marrë edhe një herë fjalën. Zoti Koci e ka fjalën!

GANI KOCI: Unë vetëm dua një sqarim për opinionin dhe për vetë anëtarët e Kuvendit.

Komisioni nuk është në mbrojtje të Trustit dhe në këtë rast nuk e luan rolin e Trustit, absolutisht. Komisioni e ka shqyrtuar një kërkesë të Trustit Pensional, të cilën të gjithë anëtarët e Komisionit që janë nga të gjitha subjektet politike e kanë miratuar, në të vërtetë të gjithë anëtarët e Komisionit kanë kërkuar të njëjtat dokumente shtesë dhe argumente shtesë rreth kësaj kërkesë të Trustit. Përgjegjësit e Trustit kanë thënë, kanë dal me arsyetimin e saj, sepse Trusti sot nuk funksionon se nuk ka Bord të Trustit dhe në mungesë të saj kanë shkuar sipas një praktike nga vitet e kaluara që ka qenë prej 1% ka ra në 0.9% dhe këtë vit 0.8% duke pasur parasysh një dinamikë të rritjes të këtij fondi, ka ardhur deri te zbritja e tarifës dhe me këtë, po them me këtë formulë këtë propozim që të ulët tarifa.

Dua t'ju shpjegoj edhe diçka se buxhetin e Trustit Pensional të Kosovës e miraton ky Kuvend mbi bazën e tarifës përcaktuese të këtij, sepse edhe buxheti ose projektbuxheti do të bëhet mbi këtë bazë dhe ai buxhet përpara është miratuar nga Përfaqësuesi Special, kurse tani i dërgohet Kuvendit të Kosovës për miratim.

Projektbuxhetin e këtij Trusti nuk e kemi në dorë ne si Kuvend dhe as si Komision, sepse nuk mund të bëhet pa e pasur për bazë këtë tarifë të cilën do ta miratojë ose nuk do ta miratojë ky Kuvend. Këto kanë qenë arsyetimet, këto janë arsyetimet edhe të Komisionit, prandaj në emër të Komisionit edhe të rekomandimeve të Komisionit kërkoj që të votohet dhe pastaj të kërkohet Projektbuxheti për Trustin ku ne do t'i shtrojmë edhe t'i analizojmë të gjitha të tjera.

KRYESUESI: Ju Faleminderit, zoti Koci!  
Atëherë shkojmë me deputetët e Parlamentit, që janë paraqit për fjalë.  
I pari është, zoti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!  
Të nderuar deputetë,

E thanë edhe parafolësit e mi se, edhe e bënë si pyetje, në formë të pyetjes se çka do të thotë kjo 0.9, kjo 0.8. Unë sinqerisht nuk e di se si Komisioni ka ardhur në përfundim me dy fjali, pa pasur ndonjë dokument shtesë se në çfarë baze na rekomandon që të miratohet kjo kërkesë e Trustit.

Ligji që e kemi miratuar ne dhe ligji në të vërtetë që është amendamentuar, me të cilin është amendamentuar Rregullorja 2005/20, shumë qartë e definon se Trusti është i obliguar me ligj të raportojë, por edhe nëse nuk kishte qenë me ligj i obliguar të raportojë, atëherë duke pasur parasysh krizat financiare që ndodhin nëpër tërë botën, që kanë tronditur të gjitha shtetet, ka qenë e ndershme, ka qenë etike që së paku t'u tregojë qytetarëve të vet se çka po ndodh me paratë e tyre? Pra, kjo është përgjegjësi e Trustit. Por, sido që të jetë raporte vjetore nuk ka, raporte tremujore nuk ka, arsyetimet janë se Ligji veç sa ka kaluar në qershor, që normalisht janë arsyetime deri diku të pranueshme, por kërkesa, gjykimi që të zbritet tarifa në 0.8, nuk po më duket se është e ndërtuar mbi premisat e rregullta, sepse nuk ka arsye pse të jetë 0.8.

Konkretisht unë do të propozoja për shembull që të ulet në 0.5. Logjika dhe gjykimi mbi bazën e asaj se çka ka ndodhur përpara me një linearitet prej 0.1 të ulet nga viti në vit, a thua do ta përcjellë vitin e ardhshëm? Me qenë se, gjithashtu, edhe Trusti është i obliguar që të raportojë lidhur me shpenzimet që ndodhin mbi në atë organizatë, atëherë unë propozoj nga ky Kuvend që mos të miratohet ky propozim, jo të shtyhet për seancat e ardhshme pas tre apo katër muajve, por që të kërkohet nga Trusti që ta përgatisë një arsyeshmëri për ndryshimin e tarifave. Nuk mund të themi se po e ulim apo po e rrisim, veç duhet ta shohim arsyeshmërinë, sepse nuk është e mjaftueshme arsyeshmëria e bazuar në eksperiencën paraprake.

Nuk është e arsyeshme, nuk ka mundësi që të gjykojmë ne, të themi 0.8. Çka nëse për shembull do të ishte e arsyeshme që të zbritet në 0.5, në 0.6, kah erdhi 0.8?

Më falni, jemi duke folur sipas Ligjit që është miratuar në Kuvendin e Kosovës, kjo, e po amendamentohet, kështu që unë propozoj që të rishqyrtohet edhe një herë kjo pikë, që të kërkohet dokumentacion shtesë dhe që në këtë seancë të mos votohet diçka për çka nuk e dimë çka do të votojmë?

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Rrushemi! Zoti Tali e ka radhën. Deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë paraprakisht, ndonëse nuk është zoti kryetar këtu, por desha t'i ankojem se e bëra një pyetje pikërisht në këtë kontest sot te ministri përgjegjës, u pa se ministri nuk ka lidhje me këto. Flas për ministrin e Mirëqenies dhe e Punës.

Nga ana tjetër, ministri tjetër i cili është përgjegjës për çështjen që e diskutojmë, nuk është këtu fare. Nuk e kemi as guvernatorin e Bankës Qendrore, po them, gjithmonë po mbështetem në Ligj, por para se të hyjë aty, një kritikë të vogël Komisionit, ndonëse kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa u mundua të arsyetohet se ka kërkuar

informata shtesë nga Trusti dhe ata nuk i kanë sjellë, kjo nuk është arsyetim për shkak se sipas Ligjit, të cilin na e kanë sjellë dhe është bërë kërkesa, flas për Ligjin 03/L-084, ata janë të obliguar, nuk është çështje se a dëshirojnë a nuk dëshirojnë, por janë të obliguar me ligj dhe këtu duhet të sjellin informatat e kërkuara. Është dashur Komisioni të jetë kategorik, aq më shumë kur të kenë të bëjnë me një gjë që do të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2009, do me thënë ne nuk e miratojmë për këtë vit, por për 1 janarin, pra duke filluar nga 1 janari i vitit 2009, që do me thënë edhe disa muaj kemi kohe. Pra nuk jemi për ngutë.

Unë thashë sot në seancën e drekës, se kjo 0.8%, e përsëritën edhe të tjerët, nuk na jep kurrfarë informate neve. Ne nuk di si mund të votojmë për një përqindje që nuk kemi informata, nuk dimë, është një e panjohur.

Po ashtu, do të doja edhe një replikë të vogël ta bëjë në arsyetimin se Bordi i Trustit nuk është krijuar, te them se kjo nuk është çështje e Bordit që informatat të na i japë, sepse kjo është çështje operacionale nuk është çështje strategjike. Ata atje kane Departamentin Financiar, i kane zyrtarët financiar, e kanë drejtorin financiar te cilet duhet te na i sjellin ato informata. Ne jemi kah kërkojmë ato shifra që të na i japin, në bazë të të cilave ata e kanë qitë 0.8 %, e pastaj do të merremi me çështje strategjike se a e meriton të jetë 0.8% apo jo.

Unë tash po them, pasi nuk është këtu ministri i Financave, por duke i parë edhe ministrat tjerë që fare nuk po i lexojnë ligjet, ta kenë në dijeni se për Trustin që nga 15 qershori 2008, ata janë përgjegjës, sipas Ligjit, të cilin ne këtu e kemi miratuar. Shumë bukur thotë se këtu “grupi i punës ndërminstor për politikën e pensioneve, i cili përbëhet nga ministri i Ekonomisë dhe Financave, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Guvernatori i Bankës Qendrore dhe anëtarë tjerë të emëruar nga Kryeministri, sipas nevojës propozojnë rregulla dhe rregullore të nevojshme për zbatimin e politikës pensionale”. Shumë qartë është, mos ta lexoj deri në fund, do me thënë që nga 15 qershori, Qeveria është përgjegjëse për humbjen e parave të Trustit. Pse nuk kanë reaguar deri tash - janë para të mëdha a nuk e dine ende. Une e kam një figurë, unë shumë mirë e di deri ku kanë humbur (rreth 50 milion) kontribuuesit kosovar, por nuk janë më përgjegjësi e UNMIK-ut, nuk janë gjynahe të UNMIK-ut, janë të kësaj Qeverie, që nuk i lexojnë ligjet. Është problem i tyre, ju lutem dhe mos te na imponohet diçka që nuk mundemi, nuk është në ndërgjegjen tonë si kontribuues, por edhe si përfaqësues të kontribuuesve të votojmë diçka që pastaj të na hakmerret pa nevojë, ju lutem. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Tali! Në radhë është zoti Fatmir Rexhepi. Zoti Rexhepi, e keni fjalën!

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti drejtues i seancës!

Edhe në fillim të kësaj seance, unë kërkoja që megjithatë të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, çka po e tregon edhe realiteti tash gjatë këtij debati që po e nxjerrim para veti, sepse mendoj se këto dilema, këto dyshime duhet të sqarohen, në mënyrë që kur të votojmë të kemi për çka të votojmë. Prandaj unë si deputet jam kundër që sot të votohet

kjo, jo se jam kundër asaj që një kërkesë që kërkon të zvogëlohen tarifat, në bazë të ligjit dhe të tjera, do të ishte abnormale në qoftë se kërkohet të mos votohet, por realisht, kjo mos përgatitje dhe mosnjohje e situatës po na detyron ta marrim një vendim të atillë.

Unë po habitem me mungesën e vullnetit nga ana e Qeverisë që është përgjegjëse, pse nuk po e përgatit këtë raport- këtë informatë. Shumë mirë e tha zoti Tali, ka njerëz atje që e marrin rrogën, nëse i kujtohet ndokujt, nëse i ka ndjekur emisionet televizive më herët, kur dilnin po këta ekspertë dhe në Televizion deklararin se përafërsisht sa i kanë pagat atje 5000 apo 10.000 euro e 12.000 euro e janë aty duke punuar, këto janë para tona të 400.000 punonjësve. Bile- bile, sipas informatave që mund të jenë krejt të dyshimta edhe këtë që po e them unë, njerëzit, ndoshta, kanë blerë edhe doktorate edhe magjistratura... e po vijnë po shesin mend në Kosovë, e ne nuk po mund domethënë, si të themi, ta bëjmë një debat real e objektiv për të parë se kush është përgjegjës. Tash, si ka mundësi bie fjala ta dimë na që realisht po e thonë këtë - a është 0.8, a është 0.2 a është 0.6?

A e din dikush, edhe sa para kanë mbetur në atë Fond të Pensioneve? Askush nuk e dinë. Këtu jo. Si po ndahen këto mjete, askush nuk po e dinë, nuk e kemi të shkruar as prej Komisionit? Pra, në qoftë se supozohet që nuk është për t'u besuar, do të thotë thashethemeve ose dyshimeve të tjera, në qoftë se i kanë humbur po e zë 50% të këtyre mjeteve, mund të jenë 200 milionë, atëherë nuk ju dalin mjetet për të punuar për t' i pasur rrogat 5000-6000 euro, hyjmë në gjynah me ta. Kështu që nuk ka kuptim do të thotë ta marrim një vendim pa e ditur për çka po bëhet fjalë. Prandaj del, të gjitha argumentet të qojnë aty që informata duhet të silllet në Parlament dhe mbi bazën e asaj informate, pastaj të marrim rekomandime dhe Qeveria t'i marrë vendimet e tjera. Pra, të mos lejojmë që edhe më tutje, domethënë ta habisim opinionin apo të lejojmë që të tregtohet me këto mjete, me këtë fond, me këtë institucion të kursimeve të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Pra, ju lutem që të keni konsideratë për këtë kundërshtim timin që do ta bëj sot në Parlament.

**KRYESUESI:** Ju faleminderit, zoti Rexhepi!

Po besoj se propozimet, të paktën tri metoda janë, tri alternativa, voton "për", voton "kundër" ose abstenon, domethënë nuk prish punë ajo.

Në radhë është zoti Riza Smaka.

**RIZA SMAKA:** Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Për mua si qytetar dhe deputet është shumë imituese, edhe negativisht intriguese faktografia se Trusti i Pensioneve të Kosovës, Trust do të ishte besim në njëfarë mënyre, është një institucion antibesim, një institucion tekno-burokratik, abuzues me mjetet e qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë pensione nëpërkëmbese shumë të ulëta, përbuzëse edhe në kundërshtim me solidaritetin, me reciprocitetin, me moralitetin. Bordistët e këtij Trusti, marrin paga marramendëse, absolutisht me asgjë dhe në asnjë mënyrë të justifikuar: 7000, 10.000, 12.000 euro, ndërsa pensionisti ynë, i cili do të meritonte një pension sado kudo njerëzor, merr një pension, i cili është kuazi edhe pseudo pension.

Dikur ka ekzistuar, që do të duhej tash të mburremi se ishte keq e tani më mirë, një institucion që është quajtur Bashkësi Vetëqeverisëse e Interesit për Sigurim Invalidor Pensional, e cila Bashkësi brenda një viti kalendarik i ka prezantuar katër bilance periodike më në fund edhe përfundimtare, dhe çdo cent, i siguruari e ka ditur ku është, e ku shkon, e pse shkon, e pse nuk shkon, ndërsa sot, sikurse këto të ishin paratë të Bordit të Trustit, absolutisht askush nuk di sa para janë. Humbin 30 milionë, 40 milionë, së paku flas me të dhënat e shtypit, askush nuk përgjigjet, ndërsa në vend që të jepeshin përgjegjësi, të shkarkoheshin, të hapej procedurë penale kundër atyre që shkaktojnë humbje të tilla, se humbjet mund të shkaktohen me dashje, në mënyrë dolloze, por edhe pa dashje, në mënyrë kullpoze( ka kullpallata, kullpallebis etj.), apo jo. Ata marrin paga 10.000 euro, 12,000 euro, katër paga më të larta se Kryetari, Presidenti i Republikës së Kosovës.

Kjo është e patolerueshme. Kuvendi i Kosovës nuk mund të jetë indiferent edhe të lejojë kësisoj, as nuk kemi kurrfarë pasqyre se çka do të thotë 8% apo 7%, prandaj zoti kryesues, ju lutem, do të isha angazhuar që për seancën tjetër, në mënyrë që të jemi kompetent për ta ngritur dorën “për” apo “kundër” ta kemi një pasqyrë sa janë pagat e atyre, sa janë shpenzimet, a janë të justifikueshme apo nuk janë dhe ta dimë se përqindja e caktuar çfarë mase jep, ndryshe do të ishte abuzim i funksionit të deputetit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Smaka!  
Radhën e ka zoti Berim Ramosaj. Zoti Ramosaj!

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!  
Faktikisht atë çka e pata ndër mend ta them e thanë shumë kolegë. Unë kam vërejtje principiele te kolegët e nderuar deputetë që janë anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa, sepse rekomandimi na ka ardhur nga ata.

Këtu, në qoftë se vërtetë ka disponim të bisedohet për Trustin, ne mund ta përfshimë si pikë të rendit të ditës për Trustin, gjendjen në Trust, gjendjen e mjeteve e të tjera, është çështja për një tarifë e cila na propozohet nga Komisioni për Buxhet, që në fakt po shihet që as Komisioni nuk ka pasur informatë të mjaftueshme. Për këtë me keqardhje edhe njëherë e shpreh, nuk ka mund deri në këtë moment kryetari i Komisionit për këto rekomandime të na bind neve, sepse në fakt po shihet se as ai vetë nuk është i bindur.

Andaj, edhe një herë edhe si Grup Parlamentar ne njëfarë forme e kërkuam të mos shqyrtohet sot, prapë po kërkoj mos të shqyrtohet. Shikuar nga aspekti profesional, kjo është një tarifë e cila, në qoftë se shihet në masën e rritur të mjeteve të Trustit, edhe nëse zbritet në 8% nuk u zvogëlohen të ardhurat personale atyre menaxherëve, jo nuk u zvogëlohen, sepse është rritur masa. Në qoftë se shikohet nga aspekti i mjeteve të mundshme të humbura tash në tregun financiar që janë plasuar mjetet në tregje të ndryshme, ka shans që edhe janë zvogëluar ato mjete. Sidoqoftë, unë kërkoj së pari Komisioni për Buxhet të jetë më syçelë, i kam kolegë të nderuar, nuk po mund t'i kritikoj, sot kanë rënë prej provimit, në njëfarë forme dhe kur na vjen ne rekomandimi

këtu, vërtet duhet të na bindin se një rekomandim i tillë ka arsyeshmëri edhe materiale edhe politike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ramosaj! Fjalën e ka Gani Buçinca

GANI BUÇINCA: Të nderuar kolegë,

I nderuari zoti kryesues,

Më lejoni që edhe unë t'i them disa fjalë në lidhje me propozimin të cilin po e shqyrtojmë.

Për mua si qytetar dhe deputet është krejt irelevante shkalla, përqindja e tarifës së menaxhimit të parave të Trustit. Unë jam prej atyre të cilët dëshirojnë që gjërat të zgjidhen drejt, në mënyrë parimore dhe problemet të shikohen aty ku kanë lindur.

Unë, megjithatë e falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa, që na e ka dhënë një propozim të tillë, mirëpo kisha dëshiruar që për këtë çështje, e cila e prek një përqindje të madhe të qytetarëve të Kosovës, në gjendjen aktuale që është, duke u nisur nga kriza globale financiare, tregjet financiare, globale çfarë janë, shqetësimi i madh i qytetarëve për këto çështje, që Komisioni për Buxhet dhe Financa ta bëjë një trysni ndaj Komisionit ndërministror, i cili duke shfrytëzuar kompetencat ligjore duhet të na e sjellë një raport nga Trusti Pensional, kurse Komisioni për Buxhet e Financa duhet ta hetojë mirë gjendjen financiare në Trust dhe pastaj të na i përgatit rekomandimet neve këtu si deputetë për të marrë vendime adekuate për t'i mbrojtur paratë e qytetarëve të Kosovës, në njëfarë mënyre edhe paratë tona këtu si deputetë.

Unë i them kolegut tim të nderuar Driton Talit se për gjendjen e krijuar në Trust, nuk është përgjegjëse Qeveria e Kosovës. Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për neglizhencën që nuk po reagon nga qershori e këndeje, nuk është alarmuar për gjendjen në Trust dhe nuk po merr masa adekuate ligjore, kurse Trustin nuk e ka krijuar kjo Qeveri. Paratë të cilat janë investuar në tregjet financiare, nuk kanë qenë me vendim të kësaj Qeverie. Kjo Qeveri në shumë sfera të jetës në Kosovë, i trashëgon problemet shumë të thella që i kanë shkaktuar të tjerët dhe nuk ka shkop magjik që mund t'i zgjidhë me atë shpejtësi, mirëpo, sa i përket neglizhencës që nuk po reagon, unë pajtohem plotësisht me ty. Duhet të reagojë shpejt për t'i mbrojtur qytetarët e Kosovës, mirëpo duhet të reagojë edhe Kuvendi për këtë çështje, edhe ne jemi po aq përgjegjës sa Qeveria që të reagojmë dhe ta vlerësojmë drejt gjendjen si është në Trust- a e justifikon ekzistimi i një Trusti të këtillë, i cili qytetarit nuk i garanton që do të jetë në pleqëri pa para, mund t'i humb pas 10 vjetëve Trusti të gjitha kursimet edhe qytetarët e Kosovës mbesin pa pensione. Domethënë, duhet të rishikohet mirë infrastruktura ligjore aktuale e cila është dhe të krijohen agjencione alternative pensionale në Kosovë, të cilat do të japin siguri më të mëdha për qytetarët kur t'ju vijë pleqëria, se në këtë Trust, unë nuk kam asnjë fije besimi se unë do ta gëzoj pensionin tim kur ta arrij kohën e pleqërisë.

Për mua nuk është me rëndësi të votohet për këtë çështje, por unë e falënderoj, megjithatë, Komisionin, i cili na dha mundësinë që së paku t'i shprehim disa mendime për gjendjen që është në Trust dhe të mos votojmë fare se është krejt irelevante, por këtë pikë të debatit ta përfundojmë që Kuvendi ta autorizojë Komisionin Financiar që

ta bëjë një hetim të shpejtë në Trust dhe të na e paraqet një raport dhe rekomandime si duhet të veprojmë ne si Kuvend i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Buçinca! Radhën e ka, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konsideroj se kjo çështje do të mbyllet edhe të mos votojmë për arsye se nuk janë prezent 2 ministrat, që kanë përgjegjësi të kenë informatë të plotë rreth gjendjes së Trustit Pensional.

Dihet se Trusti është krijuar me një rregullore të UNMIK-ut dhe është thënë atëherë me rastin e krijimit se për shkaqe sigurie, mjetet mbahen në banka ndërkombëtare. Pra, kërkesë e jona në vazhdimësi ka qenë si Qeveri e kaluar që Trusti Pensional të administrohet dhe të drejtohet nga niveli vendor, por tash na sillen shifra pa asnjë elaborim, një përqindje e caktuar që nuk e dimë fare se çka flet, nuk është në rregull, prandaj, disponimin po e shihni, nuk është mirë të humbim kohë, por ta shtyjme, jo ndoshta, për seancën tjetër, por kur të jenë prezentë ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale dhe ministri i Financave, nëse duam të kemi një raport të plotë për gjendjen e Trustit Pensional dhe për këtë shifër që neve na ofrohet me përqindje. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Isufi! Të drejtën e replikës e ka zoti Tali me kohën përkatëse.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë isha shumë i qartë kur thashë nga 15 qershori 2008, Qeveria është përgjegjëse për atë që po ndodh me Trustin Pensional të Kosovës në kuptimin e ndryshimit të procedurave investuese, që me këtë ligj që këtu i referohet, i takon Qeverisë.

Sa për informim dua kështu ta cek, sot unë e pyeta ministrin e Mirëqenies siç ishit edhe ju te gjithë këtu dëshmitare okulare, ai u përgjigj se “haber s’ kishte”. Edhe vetë tha se nuk di. Po ashtu prej qershorit deri në shtator janë bërë shume pyetje për Trustin, për performancën e Trusti. Por Ministri i Financave është përgjigjur duke folur “Shkup e Shkodër” por pa dhënë përgjigje konkrete. Pra as ai nuk ka ditur për përgjigjësit që i ka nga 15 qershori. Unë e kam pritur këtë moment për t’i thënë atij edhe Qeverisë, hapni sytë se është një çështje shumë serioze dhe mos merrni përgjigjësi kur nuk dini, o burra! Thirrni njerëz që dinë. Këtë e thashë, domethënë nga 15 qershori jam duke folur, nuk jam duke folur nga 2002 kur është krijuar Trusti. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Tali! Fjalën e ka tani, zoti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të jem shumë i shkurtër, por do të përqendrohem në letrën që iu ka drejtuar edhe Komisionit përmes kryetarit të Kuvendit dhe të nderuarve deputetë.

Pak më poshtë, mos ta lexoj krejt letrën, mos t'u marr kohë, thotë: “Me fuqi prej 1 janari 2009, Bordi udhëheqës i Trustit propozon për miratim të Kuvendit, (është gabim, por nuk ka lidhje) -zbritjen në taksën vjetore menaxhuese prej 0.9 – 0.8 të mjeteve. Kjo zbritje bazohet në analizën e pozitës ekzistuese dhe të parashikuar buxhetore të Trustit” Kjo pikë nënkupton që Bordi udhëheqës e ka një arsyeshmëri, e ka një dokument me të cilin po kërkon zbritje. Prandaj, ne si deputetë nuk po kërkojmë asgjë më tepër, por këtë arsyeshmëri që e ka paraparë këtu, që thotë: “Ekziston dokumenti për arsyeshmëri” ta dorëzojë pranë deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe të kemi mundësi, që ne si deputetë të vendosim për çka po votojmë.

Krejt në fund, meqë pati propozime që kjo pikë e rendit të punës të shtyhet për diskutim, është mirë që ta hidhni në votim, që kjo pikë të diskutohet në njërën nga seancat e ardhshme dhe të kërkohet nga Bordi udhëheqës që të na pajis komplet me dokumentacion, e pastaj Komisioni për Buxhet dhe Financa ta shqyrtojë shumë mirë dokumentacionin dhe të propozoj rekomandime për Kuvend. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni! Në radhë është zoti Zemaj. Zoti Zemaj, e keni fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ndoshta edhe u thanë shumë gjëra, por më duket se nuk do të kenë efekt tani edhe diskutimet. Unë prita pak më shumë nga ata që kanë tituj të ekspertëve dhe janë deputetë të nderuar apo profesorë të universiteteve, për këtë çështje së paku në mënyrë shkencore të na japin një pasqyrë, sepse neve me të vërtetë na ka munguar edhe atë ditë kur është diskutuar në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Pra, ne jemi munduar që, sipas ligjit edhe sipas kërkesës së parashtruar të kësaj tarife menaxhuese, e cila është kuptuar që është për të mirën e njerëzve apo të atyre që paguajnë, janë kontribuues të drejtpërdrejtë- ulja e tarifës, me të vërtetë është e konvencueshme, por se sa duhet të jetë tani ajo përqindje, as ne, por as ata përfaqësues të cilët kanë qenë të pranishëm, drejtori i Trustit, nuk e kanë dhënë në mënyrë të saktë.

Neve na ka konvencuar ulja e tarifës, sepse është bërë arsyetimi në bazë të rritjes të aseteve dhe ne e kemi parë të arsyeshme që ajo ulje i konvenon atyre që kontribuojnë drejtpërdrejt.

Së pari, a është ministri këtu i Financave a nuk është, a është ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, e gjithë Kosova edhe të gjithë njerëzit që së paku kanë dijeni një minutë në ekonomi, humbja ka ndodhur në vitin 2008 edhe ajo është e pranueshme edhe nga ata që e udhëheqin Bordin e Trustit Pensional të Kosovës, apo ata të cilët direkt menaxhojnë me paranë. Kjo është e qartë edhe kjo është publike. Si e diskutuam ne sot, se si ka ardhur arsyeja apo cilat nuk janë arsytet, të cilat do të jenë, ajo është një çështje tjetër? Ne mund të bëjmë sot politikë edhe të shesim edhe mend këtu se cili është më i mençur në kuadër të këtij aspekti ekonomik, por humbja ka ndodhur edhe atë e di çdonjëri deputet e din sot këtu që humbja në vitin 2008 ka ndodhur jo vetëm në Trustin tonë, por ka ndodhur në gjithë tregun, ka rënie në tregjet globale.

E vetmja garanci që është dhënë nga anëtarët e Trustit, është se 5%, i cili është i lejuar të financohet në Kosovë, aty ka garanci, aty nuk ka humbje të mjeteve. Për të tjerat, të cilat janë jashtë vendit edhe ata vet e kanë pranuar se në vitin 2008 ka humbje nga mjetet e Trustit Pensional të Kosovës.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Zemaj! Në emër të Grupit a doni për t' u paraqitur zoti Sabri Hamiti?

KRYETARI: Fjalën e ka në emër të Grupit të Lidhjes Demokratike, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,

Zoti kryesues,

Deri para dy minutash ne e kishim një propozim që na ka ardhur nga Komisioni dhe unë mendoj që është zhvilluar një debat shumë i arsyeshëm, shumë substancial, më i madh se që është paramenduar kur ka ardhur ai propozim dhe vetë debati, në të cilën morën pjesë edhe shefat e grupeve parlamentare dhe kryetarët e Komisionit, tash me logjikën dhe vetëdijen e një deputeti- përfaqësuesit të interesave publike dhe civile në Kosovë, unë rezymoј që nga gjithë kjo t'ju bëj një propozim në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, që sot mos të votohet propozimi, të mos votohet jo në kuptimin proceduralisht mos të votohet as "për" as "kundër" as abstenim, sepse të gjitha diskutimet thonë që edhe propozimi që është, duhet të mbështetet nga një informatë e kësaj agjencie. Pra, urgjentisht Kuvendi kërkon pas këtij diskutimi informatë plotësuese për tarifat rreth menaxhimit dhe kjo të bëhet në mbledhje tjetër. Ky është propozim i LDK-së, dhe i lus grupet tjera të na mbështesin.

KRYETARI: ... Mendimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Ju lutem, Ramë Buja e ka fjalën!

RAMË BUJA: Zoti Kryetar!

Unë mendova se me sqarimet nga Komisioni do të qartësohet diçka, e mua më është turbulluar tërësisht kjo punë dhe me keqardhje për kolegët e mi të nderuar të Komisionit, por thjesht ka krijuar konfuzion, nuk ka sqaruar asgjë edhe unë jam i shqetësuar që Komisioni bart për Kuvendin diçka për të cilën nuk di vet çfarë është. Por, meqë është këtu problemi, atëherë unë e mbështes absolutisht kolegun tim nga LDK-ja, që kjo çështje të shtyhet, të sqarohet dhe pastaj të vijë në Kuvend, përndryshe unë nuk di çfarë votoj, sepse është krejtësisht konfuze kjo gjë.

I falënderoj shumë kolegët e mi që debatuan dhe i kontribuan asaj që së paku të vijmë te kjo pikë që nuk bëme asgjë.

KRYETARI: A e mbështetni këtë ju grupet tjera? Ju faleminderit! Do të thotë e shtyjmë për seancën tjetër. Asnjë debat lidhur me këtë, shtyhet për seancën tjetër.

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa që të kërkoј... Mirë Kuvendi e kërkon edhe... Ju lutem, le ta mësojmë një kulturë të komunikimit dhe pa e kërkuar fjalën, mos ta marrë.

Kryetari e din kujt ia jap fjalën për atë është këtu. Këtu shkruan për Komisionin për Buxhet dhe Financa, dhe ju lutem. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.

Ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ka vendosur që anëtar në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, në vend të deputetit Lutfi Haziri të emërohet deputeti Armend Zemaj.

Gjithashtu, Grupi Parlamentar i AKR-së ka vendosur që anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetit Behxhet Pacolli, të emërohet deputeti Riza Smaka, ndërsa në Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, në vend të deputetit Riza Smaka, të emërtohet deputeti Ibrahim Makolli.

Me këto njoftime e deklaroj të mbyllur seancën. Mirë u pafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

**Njësia e Transkripteve**